



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 5967/Prot.

Tiranë, më 31.07. 2026

URDHËR

Nr. 400, datë 31.07 2026

PËR

**MIRATIMIN E LLOJEVE TË PROGRAMIT “PAS SHKOLLE”, STANDARDEVE,
KRITEREVE, PLANIT TË VEPRIMIT PËR OFRIMIN E KËTIJ PROGRAMI, SI
DHE PËRCAKTIMIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 4, të nenit 47/1, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të urdhrit nr. 579, datë 11.11.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Herida Duro”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e llojeve të programit “pas shkolle”, standardeve, kritereve, planit të veprimit për ofrimin e këtij programi, si dhe përcaktimin e institucioneve publike të arsimit parauniversitar për organizimin dhe zbatimin e programit “pas shkolle” në arsimin parauniversitar, përkatësisht sipas shtojcave nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4 dhe nr. 5, që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore rajonale dhe vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

HERIDA DURO



Shtojca nr. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI “PAS SHKOLLE”
NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**



PËRMBAJTJA

I.	HYRJE.....	3
II.	PROGRAMI "PAS SHKOLLE".....	5
2.1	<i>Parimet themelore të programit.....</i>	5
III.	PËRMBAJTJA DHE PLANIFIKIMI I PROGRAMIT "PAS SHKOLLE" NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR.....	10
3.1	PROGRAMI "PAS SHKOLLE" NË ARSIMIN FILLOR.....	12
3.1.1	<i>Përshkrimi i përmbajtjes së programit "Pas shkolle" në arsimin fillor.....</i>	13
3.1.2	<i>Organizimi i programit "Pas shkolle" në AF.....</i>	15
3.1.3	<i>Modele të planifikimit të përmbajtjes së programit "Pas shkolle" në AF.....</i>	16
3.2	PROGRAMI "PAS SHKOLLE" NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT (AMU).....	18
3.2.1	<i>Përshkrimi i përmbajtjes së programit "Pas shkolle" në arsimin e mesëm të ulët.....</i>	19
3.2.2	<i>Organizimi i programit "Pas shkolle" në AMU.....</i>	19
3.2.3	<i>Modele të planifikimit të përmbajtjes së programit "Pas shkolle" në AMU.....</i>	20
3.3	PROGRAMI "PAS SHKOLLE" NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË (AML).....	22
3.3.1	<i>Përshkrimi i përmbajtjes së programit "Pas shkolle" në arsimin e mesëm të lartë.....</i>	23
3.3.2	<i>Organizimi i programit "Pas shkolle" në AML.....</i>	23
3.3.3	<i>Modele të planifikimit të përmbajtjes së programit "Pas shkolle" në AML.....</i>	24
IV.	MENAXHIMI NË INSTITUCIONIN ARSIMOR I PROGRAMIT "PAS SHKOLLE".....	26
4.1	<i>Zbatimi i programit "Pas shkolle".....</i>	26
4.2	<i>Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e programit "Pas shkolle".....</i>	27
V.	SHTOJCA.....	31
	<i>Shtojca 1: Modele të orarit ditor dhe të kalendarit javor për programin "Pas shkolle" për Arsimin fillor (klasat I-V).....</i>	31
1.1.	<i>Modele të orarit ditor për programin "Pas shkolle" për klasat I-V.....</i>	31
1.2.	<i>Modele të kalendarit javor për programin "Pas shkolle" për klasat I-III.....</i>	32
	<i>Shtojca 2: Modele të orarit ditor dhe të kalendarit javor për programin "Pas shkolle" për Arsimin e mesëm të ulët (klasat VI-IX).....</i>	35
2.1.	<i>Modele të orarit ditor për programin "Pas shkolle" për klasa VI-IX.....</i>	35
2.2.	<i>Modele të kalendarit javor për programin "Pas shkolle" për klasa VI-IX.....</i>	35
	<i>Shtojca 3: Modele të orarit ditor dhe të kalendarit javor për programin "Pas shkolle" për Arsimin e mesëm të lartë (klasat X-XII).....</i>	37
3.1.	<i>Modele të orarit ditor për programin "Pas shkolle" për klasa X-XII.....</i>	37
	<i>Shtojca 4: Modele të angazhimit të trajnuesit të BDSH dhe KAZ në programin "Pas shkolle".....</i>	39
VI.	BIBLIOGRAFI.....	41

I. HYRJE



Programi “Pas Shkolle” është një program edukativ dhe zhvillimor që plotëson arsimin formal, duke u ofruar nxënësve mundësi të strukturuar për të nxënë, për të zhvilluar aftësi të reja dhe për të shfrytëzuar në mënyrë cilësore kohën pas përfundimit të procesit të rregullt mësimor. Programi organizohet jashtë orarit të detyruar dhe synon të mbështesë zhvillimin akademik, social, emocional, krijues dhe kulturor të nxënësve, në përputhje me moshën, interesat, prirjet dhe nevojat e tyre.

Bazuar në praktikën e vendeve anëtare të OECD-së, në përvojën e deritanishme të organizimit të programeve “Pas Shkolle” në Shqipëri dhe në literaturën bashkëkohore, programi synon të krijojë një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe motivues, që zgjeron mundësitë e të nxënësve përtej klasës tradicionale. Ai mbështet zhvillimin e kompetencave, nxit pjesëmarrjen aktive, bashkëpunimin, krijimtarinë dhe zbulimin e talenteve të nxënësve.

Programi “Pas Shkolle” për arsimin parauniversitar ofron mbështetje për përf forcimin e të nxënësve, kryerjen e detyrave të shtëpisë, zhvillimin e shprehjeve të të nxënësve dhe përmirësimin e rezultateve mësimore. Gjithashtu, ky program përfshin klubet e arteve dhe zejeve, të cilat krijojnë mundësi për zhvillimin e aftësive krijuese, artistike, praktike dhe sociale të nxënësve. Përmes muzikës, teatrit, artit pamor, kërcimit, zejeve tradicionale e bashkëkohore dhe veprimtarive të tjera edukative, nxënësit zhvillojnë krijimtarinë, vetëbesimin, aftësitë e komunikimit dhe bashkëpunimit, si edhe ndjenjën e përgjegjësisë dhe të përkatësisë. Programi u ofron gjithashtu mbështetje shtesë nxënësve që kanë nevojë për përf forcim të të nxënësve, duke respektuar ritmin dhe nevojat individuale të secilit.

Njëkohësisht, Programi “Pas Shkolle” përbën një mbështetje të rëndësishme për familjet, pasi siguron një mjedis të strukturuar, të sigurt dhe të mbikëqyrur për nxënësit gjatë pasdites. Në këtë mënyrë, ai kontribuon jo vetëm në përmirësimin e rezultateve mësimore, por edhe në mirëqenien, mbrojtjen dhe zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve, duke mbështetur formimin e qytetarëve aktivë, krijues dhe të përgjegjshëm.

II. PROGRAMI "PAS SHKOLLE"




Programi "Pas Shkolle" është një program edukativ, zhvillimor dhe mbështetës, që organizohet nga institucioni arsimor pas përfundimit të orarit mësimor të detyruar, me pjesëmarrje vullnetare të nxënësve dhe me miratimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore. Programi synon të plotësojë përvojën arsimore të nxënësve përmes mbështetjes akademike, aktiviteteve krijuese, kulturore dhe sociale. Programi "Pas Shkolle" nuk zëvendëson procesin e rregullt mësimor dhe nuk përbën pjesë të planit mësimor të detyrueshëm. Ai ka karakter plotësues dhe zhvillohet jashtë orarit të mësimi.

2.1 Parimet themelore të programit

Programi "Pas shkolle" mbështetet në parime që sigurojnë efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e tij me nevojat specifike të nxënësve. Këto parime janë themeli që drejton hartimin dhe zbatimin e programit, duke siguruar që të gjithë nxënësit të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe të zhvillohen në mënyrë holistike.

Parimet themelore



A. Përqendrimi te nxënësi

Programi është i hartuar në mënyrë që çdo aktivitet dhe ndërhyrje të jetë e përshtatur me nevojat, interesat dhe potencialin individual të çdo nxënësi. Kjo qasje garanton që mësimi dhe aktivitetet jashtëkurrikulare të jenë të personalizuar, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës që promovon zhvillimin holistik të nxënësve. Duke u bazuar në nevojat specifike të secilit nxënës, programi synon të rrisë motivimin, angazhimin dhe suksesin akademik dhe personal të tyre.

B. Barazia dhe gjithëpërfshirja

Programi siguron akses të barabartë për të gjithë nxënësit, pavarësisht sfondit socio-ekonomik, gjuhësor ose sfidave të tjera sociale. Kjo përfshin eliminimin e pengesave që mund të kufizojnë pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitete, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë. Mbështetja për nxënësit nga grupet vulnerabël është një hapësirë thelbësore për të siguruar që të gjithë të kenë mundësinë të përfitojnë nga programi pa asnjë diskriminim.

C. Bashkëpunimi me komunitetin dhe personin që ushtron përgjegjësinë prindërore

Programi inkurajon pjesëmarrjen aktive dhe partneritetet me organizata lokale dhe familjet e nxënësve. Ky bashkëpunim krijon një rrjet mbështetjeje të fortë që kontribuon në suksesin e programit, duke siguruar që të gjitha palët e përfshira të jenë të angazhuara dhe të bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e përbashkëta. Përmes këtij bashkëpunimi, programi integron burime dhe ekspertiza të ndryshme që përmirësojnë cilësinë dhe efektivitetin e aktiviteteve të ofruara.

D. Mirëqenia dhe siguria

Programi siguron një mjedis të sigurt, mbështetës dhe mirëpritës, ku mirëqenia fizike, emocionale dhe sociale e nxënësve është në qendër të çdo aktiviteti. Ai promovon respektin, mbrojtjen, kujdesin dhe marrëdhëniet pozitive ndërmjet nxënësve, mësuesve dhe komunitetit shkollor, duke krijuar kushte që çdo nxënës të ndihet i pranuar, i vlerësuar dhe i mbështetur.

E. Inovacioni dhe krijimtaria

Veprimtaritë nxitin mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve të nxënësit, duke i pajisur ata me aftësi të nevojshme për të përballuar sfidat e shekullit 21-të. Kjo përfshin ofrimin e aktiviteteve që inkurajojnë eksplorimin e ideve të reja, krijimin e projekteve inovative dhe bashkëpunimin në grupe, duke krijuar një mjedis ku nxënësit mund të zhvillojnë dhe të zgjerojnë potencialin e tyre.

F. Parimi i interesit më të lartë të fëmijës sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës

Programi udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, duke siguruar që çdo vendimmarrje, aktivitet dhe ndërhyrje të ketë në qendër mirëqenien dhe zhvillimin e nxënësve. Në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, programi garanton një mjedis të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës, ku respektohen të drejtat e fëmijëve dhe promovohen dinjiteti, pjesëmarrja dhe zhvillimi i tyre i plotë. Ky parim orientohet në praktikë përmes marrjes së vendimeve që reflektojnë nevojat dhe interesat reale të nxënësve, si dhe përmes sigurimit të kushteve që mbështesin mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të tyre.

2.2 Objektivat e programit

Programi “Pas shkolle” përfaqëson një model të strukturuar të mbështetjes arsimore dhe zhvillimore për nxënësit, duke synuar të plotësojë dhe zgjerojë përvojën e tyre mësimore përtej orarit të mësimi. I konceptuar si një kombinim i mbështetjes akademike, aktiviteteve krijuese dhe sociale, ai synon të rrisë performancën shkollore, të forcojë aftësitë sociale dhe të kontribuojë në mirëqenien e nxënësve.

Objektivat kryesorë të Programit “Pas shkolle” janë të konceptuara në përputhje me parimet themelore, duke siguruar që programi të adresojë nevojat specifike të nxënësve dhe të kontribuojë në zhvillimin e tyre të plotë akademik, social dhe emocional.



Përmirësimi i rezultateve të nxënësve është një nga objektivat kryesorë të programit, veçanërisht për nxënësit e arsimit fillor, që mundësohet përmes ofrimit të formave të ndryshme të mbështetjes mësimore, përfshirë ndihmën në studim dhe kryerjen e detyrave të shtëpisë, orë plotësuese për nxënësit që hasin vështirësi në mësim, orë shtesë për nxënësit me prirje të veçanta, orë përforcimi, dhe orë tematike që lidhen ngushtësisht me kurrikulën shkollore. Duke u bazuar në parimin e përqendrimit të nxënësi, programi synon të ofrojë përmbajtje të përshtatura për të adresuar nevojat specifike të çdo nxënësi. Kjo qasje jo vetëm që rrit nivelin e njohurive dhe aftësive të nxënësve, por gjithashtu forcon vetëbesimin e tyre, duke kontribuar në suksesin e përgjithshëm, si në aspektin akademik ashtu edhe në atë personal.

Promovimi i zhvillimit social, emocional dhe aftësive krijuese të nxënësve është një tjetër objektiv kryesor i programit, i cili promovon zhvillimin social, emocional dhe të aftësive praktike të nxënësve përmes aktiviteteve jashtëkurrikulare të strukturuar mirë, duke përfshirë aktivitete rekreative, artistike dhe praktike.

Këto aktivitete synojnë të krijojnë mundësi që nxënësit të ndërtojnë aftësi të rëndësishme për jetën, si bashkëpunimi, zgjidhja e problemeve dhe vetë-shprehja. Duke u bazuar në parimin e barazisë dhe gjithëpërfshirjes, programi mbështet krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, ku çdo nxënës mund të përfshihet, pavarësisht sfondit të tij socio-ekonomik apo nevojave specifike. Për më tepër, këto aktivitete kontribuojnë në mirëqenien e përgjithshme të nxënësve, duke u ofruar atyre mundësi për të shprehur krijimtarinë, për të eksploruar interesa të reja dhe për të zhvilluar lidhje të forta shoqërore brenda dhe jashtë shkollës.

Bashkëpunimi me komunitetin lokal dhe inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të prindërve bazohet në parimin e bashkëpunimit me komunitetin dhe familjet, duke krijuar partneritete të qëndrueshme me organizata lokale dhe grupe prindërishe. Përmes këtyre partneriteteve, programi synon të mobilizojë burimet dhe ekspertizat që përmirësojnë cilësinë dhe diversitetin e aktiviteteve të ofruara për nxënësit. Për më tepër, përfshirja e prindërve jo vetëm që forcon marrëdhënien midis familjes dhe shkollës, por gjithashtu rrit përgjegjësinë dhe angazhimin e të gjithë aktorëve në mbështetjen e zhvillimit të nxënësve. Bashkëpunimi me komunitetin lokal sjell përfitime afatgjata, duke ndihmuar në krijimin e një rrjeti mbështetës që forcon lidhjen mes shkollës dhe komunitetit si një tërësi.

Mbështetja e zhvillimit të plotë të potencialit të fëmijëve përmes një qasje që forcon aftësinë për t'u përballur me vështirësitë, kompetencat dhe karakterin, duke krijuar një mjedis të sigurt, mbrojtës dhe mundësues për qytetarë të denjë dhe aktivë që japin kontribut në komunitet. Nëpërmjet aktiviteteve të strukturuar, programi synon të krijojë një mjedis të sigurt dhe mbështetës, ku çdo nxënës ndjehet i vlerësuar dhe i përfshirë. Kjo qasje kontribuon në zhvillimin e aftësive akademike, sociale dhe personale, duke ndihmuar nxënësit të ndërtojnë vetëbesim, ndjenjë përgjegjësie dhe aftësi për t'u përballur me sfidat. Në këtë mënyrë, programi mbështet formimin e qytetarëve aktivë dhe të përgjegjshëm, të aftë për të kontribuar në mënyrë aktive në komunitet dhe shoqëri. Garantimi i mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve përbën një komponent thelbësor të programit "Pas shkolle". Nëpërmjet mekanizmave të qartë për identifikimin, referimin dhe adresimin e çdo forme rreziku, dhune, neglizhence apo abuzimi, synohet krijimi i një mjedisi të sigurt, mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit.

Përmes ndërgjegjësimit, bashkëpunimit me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe koordinimit me institucionet përkatëse, programi kontribuon në ndërtimin e një kulture mbrojtjeje dhe respekti për të drejtat e fëmijëve, duke i fuqizuar ata të zhvillohen në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

III. PËRMBAJTJA DHE PLANIFIKIMI I PROGRAMIT “PAS SHKOLLE” NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR



Programi “Pas Shkolle” organizohet jashtë orarit mësimor dhe synon përfundimin e të nxënësve, zhvillimin e aftësive akademike, sociale, kulturore dhe krijuese të nxënësve, si dhe mbështetjen e zhvillimit të tyre të gjithanshëm.

AKAP/DRAP/ZVAP dhe institucionet arsimore parauniversitare planifikojnë, organizojnë dhe realizojnë Programin “Pas Shkolle” në përputhje me ligjin nr. 69/2012, neni 47/1 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Programi zhvillohet në institucionet publike të arsimit parauniversitar, duke garantuar sigurinë, mirëqenien dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve.

Programi “Pas shkolle” zbatohet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar:

- a) Në arsimin fillor (AF) – Klasat I-V;
- b) Në arsimin e mesëm të ulët (AMU) – Klasat VI-IX;
- c) Në arsimin e mesëm të lartë (AML) – Klasat X-XII.


Përmbajtja dhe organizimi i tij përshtaten me moshën, nivelin e zhvillimit, interesat dhe nevojat e nxënësve në secilin nivel arsimor. Programi përfshin veprimtari edukative, artistike, kulturore, krijuese dhe sociale, të cilat plotësojnë procesin mësimor, nxisin pjesëmarrjen aktive, bashkëpunimin, zhvillimin e talenteve dhe mirëqenien e nxënësve. Programi “Pas Shkolle” nuk kufizon dhe nuk përjashton organizimin e veprimtarive të tjera plotësuese dhe jashtëshkollore, projekteve, partneriteteve dhe nismave edukative, kulturore, sportive apo sociale, të zhvilluara nga institucionet arsimore në bashkëpunim me institucione publike, organizata të shoqërisë civile, partnerë zhvillimi ose subjekte të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Programi “Pas Shkolle”, përfshin veprimtaritë dhe llojet e programeve sipas niveleve:

- a) Në arsimin fillor (AF): Bëjmë Detyrat e Shtëpisë (BDSH) dhe Klubet Arte dhe Zeje (KAZ)
- b) Në arsimin e mesëm të ulët (AMU): Klubet Arte dhe Zeje (KAZ)
- c) Në arsimin e mesëm të lartë (AML): Klubet Arte dhe Zeje (KAZ)

PROGRAMI “PAS SHKOLLE”

Përfshin veprimtaritë dhe llojet e programeve sipas niveleve



3.1 PROGRAMI “PAS SHKOLLE” NË ARSIMIN FILLOR

Në arsimin fillor (AF), klasat I-V, programi “Pas shkolle” krijon një mjedis të sigurt, tërheqës dhe gjithëpërfshirës, ku nxënësit angazhohen në veprimtari që ndërthurin të nxëniet me lojën, artin, krijimtarinë, lëvizjen dhe bashkëpunimin. Përmes këtyre veprimtarive, programi mbështet përforsimin e njohurive dhe të aftësive mësimore, si edhe zhvillimin e komunikimit, vetëbesimit, shprehive të punës, marrëdhënieve sociale dhe zbulimin e prirjeve e talenteve të nxënësve.

Programi organizohet brenda javës mësimore, jashtë orarit mësimor të detyruar.

Programi “Pas shkolle” në arsimin fillor (AF) organizohet nëpërmjet këtyre llojeve të programeve:

A. Bëjmë Detyrat e Shtëpisë (BDSH)

B. Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ)

Regjistrimi dhe pjesëmarrja e nxënësve

Programi zhvillohet me nxënës që zgjedhin në mënyrë vullnetare të bëhen pjesë e aktiviteteve të tij. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore kanë shprehur dakordësi që fëmijët e tyre të ndjekin programin “Pas Shkolle”.

Pjesëmarrja e nxënësve në program bëhet mbi bazën e kërkesës së personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, përmes aplikimit në SMIP.

Nxënësi që merr pjesë në programin “Pas shkolle” në arsimin fillor, duhet të ketë qëndrueshmëri në ndjekjen e të dy llojeve të programeve: BDSH + 1 ose 2 klube KAZ.

Hapja e grupeve

Për arsimin fillor, shkollat hapin grupet në varësi të numrit total të nxënësve për këtë nivel arsimor.

- Shkollat që kanë deri në 200 nxënës në AF, hapin deri në 4 grupe.
- Shkollat që kanë deri në 400 nxënës në AF, hapin deri në 6 grupe.
- Shkollat që kanë deri në 600 nxënës në AF, hapin deri në 8 grupe.
- Shkollat që kanë mbi 600 nxënës në AF, hapin deri në 10 grupe.

Krijimi i grupeve të nxënësve

Grupet e nxënësve për secilin lloj programi krijohen në përputhje me standardet, numrin minimal 20 nxënës dhe numrin maksimal 30 nxënës pjesëmarrës, sipas përcaktimeve në urdhrin e ministrit përgjegjës për arsimin.

Regjistrimi i trajnuesve

Shprehja e interesit, përzgjedhja dhe angazhimi i trajnuesve në Programin “Pas Shkolle” realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse.

Menaxhimi i monitorimit për zbatimin e programit

Drejtori/Nëndrejtori i institucionit arsimor publik organizon dhe koordinon zbatimin e Programit “Pas Shkolle”.

Drejtori i institucionit arsimor miraton grupet e nxënësve dhe orarin e zhvillimit të veprimtarive, si dhe siguron kushtet e nevojshme për realizimin e programit.

Trajnuesi raporton në Drejtorinë e shkollës, aktivitetet e zhvilluara në kuadër të programit, si dhe evidenton pjesëmarrjen e nxënësve.

Të dhënat për organizimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve, angazhimin e trajnuesve dhe realizimin e veprimtarive administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) dhe përdoren për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e Programit “Pas Shkolle”.

3.1.1 Përshkrimi i përmbajtjes së programit “Pas shkolle” në arsimin fillor

Në vijim përshkruhet përmbajtja për secilin lloj të programit “Pas shkolle” në arsimin fillor: BDSH dhe KAZ.

A. Bëjmë Detyrat e Shtëpisë (BDSH)

Në kuadër të orëve të BDSH-së, nxënësit e arsimit fillor mund të zhvillojnë nga aktivitetet e mëposhtme:

- a) Përgatitje dhe kryerja e detyrave të shtëpisë.*
- b) Aktivitete plotësuese dhe përforcimi në lëndët bazë (matematikë, gjuhë shqipe, dituri natyre etj. sipas interesave të nxënësve dhe prirjeve të tyre).*
- c) Aktivitete përgatitore/informuese për vlerësime kombëtare, ndërkombëtare (TIMSS, PIRLS etj.), konkurse kombëtare etj.*

Sipas llojit të aktivitetit, mësuesi organizon klasën si më poshtë:

a) Përgatitja dhe kryerja e detyrave të shtëpisë

- ✓ Nxënësit në arsimin fillor (AF) ndahen në grupe paralele për klasat 1-3 dhe 4-5, nën mbikëqyrjen e një mësuesi të AF.
- ✓ Nxënësit e një grupi qëndrojnë në mjedisin e një klase të arsimit fillor.
- ✓ Mësuesi ndihmon nxënësit për vështirësitë që mund të hasin gjatë kryerjes së

detyrave.

- ✓ Nxënësit që përfundojnë më herët mund të ndihmojnë shokët e tyre.

b) Aktivitete plotësuese dhe përforsimi në lëndët bazë

- ✓ Nxënësit zgjedhin lëndët që dëshirojnë të thellojnë (matematikë, gjuhë shqipe, shkencë, etj.).
- ✓ Mësuesi përgatit detyra praktike për të zgjeruar njohuritë e tyre.
- ✓ Mësuesi përdor metoda ndërvepruese, si punë në grupe, diskutime dhe lojëra mësimore për të bërë aktivitetet më tërheqëse.
- ✓ Mësuesi identifikon nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë në bazë të rezultateve të tyre dhe kërkesës së personit që ushtron përgjegjësinë prindërore .
- ✓ Mësuesi mbështet nxënësit në kryerjen e detyrave të veçanta për të përforsuar konceptet bazë të lëndëve.
- ✓ Mësuesi zhvillon ushtrime praktike, lojëra edukuese dhe teknika të ndryshme për të ndihmuar nxënësit të përmirësojnë arritjet e tyre.

c) Aktivitetet përgatitore/ informuese për vlerësime kombëtare (VANAF), vlerësime ndërkombëtare (TIMSS, PIRLS), konkurse

- ✓ Mësuesi organizon nxënësit në grupe sipas nivelit të arritjeve dhe nevojave të tyre.
- ✓ Mësuesi zhvillon modele të testeve të mëparshme për të familjarizuar nxënësit me llojet e pyetjeve dhe formatet e testeve.
- ✓ Mësuesi zhvillon konsultime me nxënësit për diskutimin e materialeve të ndryshme të zhvilluara individualisht nga nxënësit.

Bëjmë detyrat e shtëpisë (BDSH) zhvillohet nga mësuesit (trajguesit) e arsimit fillor.

B. Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ)

Klubet e arteve dhe zejeve përfshijnë:

- Klubi i muzikës
 - Klubi i teatrit
 - Klubi i artit pamor
 - Klubi i kërcimit
 - Klubi i zejeve
- Shkolla duhet të hapë minimalisht 2 grup/klasa (BDSH+KAZ).
 - Nxënësi mund të përzgjedhë deri në 2 (dy) nga klubet e arteve dhe zejeve,

bazuar në interesat dhe prirjet e tij.

- Shkolla përgatit orarin përkatës në varësi të klubeve të krijuara.
- Klubet, sipas specifikave përkatëse dhe në varësi të prioriteteve, mund të planifikojnë 2 herë në vit aktivitete në nivel shkolle (konkurse, ekspozitë, shfaqje, panair etj.), si dhe një herë në vit aktivitete në nivel ZVAP-i ose më gjerë.
- Klubet e arteve dhe të zejeve drejtohen nga trajnues, në varësi të llojit të klubit, të përzgjedhur sipas legjislacionit përkatës.

3.1.2 Organizimi i programit “Pas shkolle” në AF

Në programin “Pas shkolle” në AF, struktura ditore e aktiviteteve hartohet në mënyrë të tillë që të ofrojë një kombinim të ekuilibruar midis të nxënësve, argëtimit dhe ndërveprimit social të nxënësve.

Orari ditor i strukturuar por gjithmonë fleksibël, sipas specifikave të shkollave, ndihmon në ruajtjen e angazhimit dhe ofron një përvojë të plotë, duke balancuar mësimin me aktivitetet fizike dhe aftësitë krijuese të nxënësve. Theksi në ndërveprimin social dhe ndërtimin e komunitetit është gjithashtu një aspekt kyç i rutinës së përditshme.

Kohëzgjatja

- Programi “Pas shkolle” organizohet pas përfundimit të mësimit të rregullt dhe zhvillohet deri rreth orës 15:00 (në varësi edhe të orarit mësimor sipas klasave), përgjatë 5 ditëve të javës.
- Plani mësimor i mësimit të rregullt i miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin, që përcakton ngarkesën javore sipas klasës, ndikon në organizimin e programit “Pas shkolle”. P.sh., programi mund të ketë organizim të ndryshëm për klasat I–III dhe IV–V, në varësi të numrit të orëve mësimore ditore.
- BDSH për një grup zhvillohet 5 orë në javë (1 orë në ditë, 60 minuta x 5 ditë). Mësuesi i BDSH -së mund të zhvillojë deri në dy grupe, pra deri në 10 orë në javë.
- KAZ për një klub zhvillohet 2 orë në javë (1 orë në ditë nga 60 minuta x 2 herë në javë).
- Kjo strukturë mund të përshtatet nga shkollat në varësi të kushteve konkrete dhe burimeve njerëzore në dispozicion.
- Trajnuesi i KAZ-së, për ciklin e AF mund të zhvillojë deri në 2 grupe për 4 orë në javë.

- Në AF:

- Për 4 grupe/klube: krijohen 2 grupe BDSH + 2 klube KAZ për Klasat I-III (4 orë gjithsej) dhe 2 grupe BDSH+2 klube KAZ për Klasat IV-V (4 orë gjithsej);
- Për 6 grupe/klube: krijohen 3 grupe BDSH + 3 klube KAZ për Klasat I-III (6 orë gjithsej) dhe 3 grupe BDSH+3 klube KAZ për Klasat IV-V (6 orë gjithsej);
- Për 8 grupe/klube: krijohen 4 grupe BDSH + 4 klube KAZ për Klasat I-III (8 orë gjithsej) dhe 4 grupe BDSH+4 klube KAZ për Klasat IV-V (8 orë gjithsej);
- Për 10 grupe/klube: krijohen 5 grupe BDSH + 5 klube KAZ për Klasat I-III (10 orë gjithsej) dhe 5 grupe BDSH+5 klube KAZ për Klasat IV-V (10 orë gjithsej).

3.1.3 Modele të planifikimit të përmbajtjes së programit “Pas shkolle” në AF

Tabela 1. Modeli i përmbajtjes së programit “Pas shkolle” për arsimin fillor (AF)

Programi “Pas shkolle”	
Dreka dhe pushim rekreativ	
Bëjmë Detyrat e Shtëpisë (BDSH)	- Bëjmë detyrat e shtëpisë (BDSH) organizohet në bazë klase dhe nxënësit punojnë me mësuesin (trajtnuesin) e arsimit fillor. - BDSH zhvillohet çdo ditë me nga 1 orë/ditë, nga dita e hënë deri ditën e premte. Ora është 60 minutëshe. - Nxënësit organizohen në grupe dhe marrin mbështetje për të forcuar dhe zgjeruar njohuritë dhe aftësitë në lëndët bazë si psh: gjuhë shqipe, matematikë, dituri natyre, gjuhë e huaj, TIK etj. Numri i nxënësve për një grup është minimumi 20 dhe maksimumi 30 nxënës. - Gjithashtu, nxënësve u jepet mundësia të studiojnë dhe të përgatiten me mbështetjen e mësuesit për ditën e nesërme.
Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ)	- Klubet e arteve dhe zejeve organizohen nga shkolla, në varësi të interesave dhe nevojave të nxënësve, si dhe të mundësive që ka shkolla.

	- Nxënësi mund të përzgjedhë deri në 2 (dy) klube të arteve dhe zejeve, sipas menisë së ofruar nga shkolla. - Nxënësit kanë detyrimin të ndjekin rregullisht klubet e përzgjedhura deri në përfundim të vitit shkollor. - KAZ zhvillohet nga dita e hënë deri ditën e premte. - Një klub zhvillohet 2 herë në javë me nga një orë në ditë. Ora është 60 minutëshe. - Klubet drejtohen nga trajnuesit sipas profilit përkatës. - Një klub mund të përfshijë minimumi 20 nxënës dhe maksimumi 30 nxënës.
--	---

SHËNIM:

Modele (shembuj) për organizimin e orarit ditor dhe kalendarit javor të programit "Pas shkolle" për klasat I-V gjenden në Shtojcën 1, në fund të këtij dokumenti. Këto modele janë orientuese. Shkollat kanë lirinë të planifikojnë dhe të organizojnë kalendarët ditorë/javorë dhe llojet e aktiviteteve në përshtatje me veçoritë e nxënësve, nevojat, prirjet dhe interesat e tyre, kushtet/mundësitë e shkollës.

3.2 PROGRAMI “PAS SHKOLLE” NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT (AMU)

Në arsimin e mesëm të ulët (AMU), klasat VI–IX, Programi "Pas Shkolle" synon të krijojë mundësi për zhvillimin e interesave dhe potencialit të nxënësve, përmes veprimtarive të organizuara kryesisht në formën e klubeve. Veprimtaritë synojnë të nxisin pjesëmarrjen aktive, krijimtarinë, bashkëpunimin, përgjegjësinë dhe pavarësinë e nxënësve, duke u krijuar mundësi të shprehin interesat, të zhvillojnë talentet dhe të ndërtojnë marrëdhënie pozitive me bashkëmoshatarët dhe komunitetin.

Programi organizohet brenda javës mësimore, jashtë orarit mësimor të detyruar.

Programi “Pas shkolle” në arsimin e mesëm të ulët (AMU) organizohet nëpërmjet Klubeve të Arteve dhe Zejeve (KAZ).

Regjistrimi dhe pjesëmarrja e nxënësve

Programi zhvillohet me nxënës që zgjedhin në mënyrë vullnetare të bëhen pjesë e aktiviteteve të tij. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore kanë shprehur dakordësi që fëmijët e tyre të ndjekin programin “Pas Shkolle”.

Pjesëmarrja e nxënësve në program bëhet mbi bazën e kërkesës së personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, përmes aplikimit në SMIP.

Krijimi i grupeve të nxënësve

Grupet e nxënësve krijohen në përputhje me standardet, numrin minimal 20 nxënës dhe numrin maksimal 30 nxënës pjesëmarrës, sipas përcaktimeve në urdhrin e ministrit përgjegjës për arsimin.

Regjistrimi i trajnuesve

Shprehja e interesit, përzgjedhja dhe angazhimi i trajnuesve në Programin “Pas Shkolle” realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse.

Menaxhimi i monitorimit për zbatimin e programit

Drejtori/Nëndrejtori i institucionit arsimor publik organizon dhe koordinon zbatimin e Programit “Pas Shkolle”.

Drejtori i institucionit arsimor miraton grupet e nxënësve dhe orarin e zhvillimit të veprimtarive, si dhe siguron kushtet e nevojshme për realizimin e programit.

Trajnuesi raporton në Drejtorinë e shkollës, aktivitetet e zhvilluara në kuadër të programit, si dhe evidenton pjesëmarrjen e nxënësve.

Të dhënat për organizimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve, angazhimin e trajnuesve dhe realizimin e veprimtarive administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) dhe përdoren për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e Programit “Pas Shkolle”.

3.2.1 Përshkrimi i përmbajtjes së programit “Pas shkolle” në arsimin e mesëm të ulët

Programi “Pas shkolle” në arsimin e mesëm të ulët (AMU) organizohet nëpërmjet Klubeve të Arteve dhe Zejeve (KAZ).

Klubet e arteve dhe zejeve përfshijnë:

- Klubi i muzikës
 - Klubi i teatrit
 - Klubi i artit pamor
 - Klubi i kërcimit
 - Klubi i zejeve
- Shkolla duhet të hapë minimalisht 2 klube.
 - Një klub hapet me minimumi 20 nxënës dhe maksimumi 30 nxënës.
 - Nxënësi mund të përzgjedhë deri në 2 (dy) nga klubet e arteve dhe zejeve, bazuar në interesat dhe prirjet e tij.
 - Shkolla përgatit orarin përkatës në varësi të klubeve të krijuara.
 - Klubet, sipas specifikave përkatëse dhe në varësi të prioriteteve, mund të planifikojnë 2 herë në vit aktivitete në nivel shkolle (konkurse, ekspozitë, shfaqje, panairë etj.), si dhe një herë në vit aktivitete në nivel ZVAP-i ose më gjerë.
 - Klubet e arteve dhe zejeve drejtohen nga trajnues, në varësi të llojit të klubit, të përzgjedhur sipas legjislacionit përkatës.
 - Trajnuesi i KAZ-së, për ciklin e AMU, zhvillon vetëm një Klub/Grup për 1 orë në ditë nga 60 minuta x 2 herë në javë.
 - Trajnuesi i KAZ, mund të angazhohet në 2 (dy) cikle të Arsimit Bazë (AF+AMU) dhe deri në 2 (dy) Institucione Arsimore Parauniversitare.

3.2.2 Organizimi i programit “Pas shkolle” në AMU

Në arsimin e mesëm të ulët (AMU), programi “Pas shkolle” organizohet përmes klubeve Arte dhe Zeje (KAZ).

Orari i veprimtarive planifikohet jashtë procesit të detyruar mësimor dhe përshtatet me kushtet specifike të çdo shkolle. Organizimi fleksibël synon të sigurojë pjesëmarrje të qëndrueshme të nxënësve, të nxisë krijimtarinë, bashkëpunimin dhe zhvillimin e aftësive praktike, artistike e sociale, duke u krijuar atyre një mjedis tërheqës për shprehjen e interesave dhe talenteve.

Kohëzgjatja

- Programi “Pas shkolle” në arsimin e mesëm të ulët (AMU) organizohet pas përfundimit të mësimit të rregullt dhe zhvillohet deri rreth orës 15:00, në varësi të orarit mësimor të klasave VI–IX. Veprimtaritë mund të shpërndahen përgjatë pesë ditëve të javës.
- Plan i mësimor i mësimit të rregullt i miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, i cili përcakton ngarkesën javore dhe ditore për secilën klasë, merret parasysh gjatë hartimit të orarit të programit. Për këtë arsye, koha e fillimit dhe ditët e zhvillimit të klubeve mund të ndryshojnë sipas klasave dhe organizimit të shkollës.
- Çdo klub zhvillohet 2 orë në javë, nga 60 minuta secili, në dy ditë të ndryshme.
- Nxënësi përzgjedh klubin ku dëshiron të marrë pjesë, në përputhje me interesat dhe prirjet e tij. Organizimi i grupeve bëhet duke marrë parasysh numrin e nxënësve të regjistruar, moshën dhe natyrën e veprimtarive.
- Shkolla harton një orar të veçantë për klubet, duke shmangur mbivendosjen e tyre me mësimin e detyruar dhe duke u krijuar nxënësve mundësi të marrin pjesë rregullisht.
- Kjo strukturë mund të përshtatet nga shkolla sipas kushteve konkrete, numrit të nxënësve, hapësirave, materialeve dhe burimeve njerëzore që ka në dispozicion.

3.2.3 Modele të planifikimit të përmbajtjes së programit “Pas shkolle” në AMU

<i>Programi “Pas shkolle”</i>	
<i>Pushim rekreativ</i>	
<i>Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ)</i>	- Klubet e arteve dhe zejeve organizohen nga shkolla, në varësi të interesave dhe nevojave të nxënësve, si dhe të mundësive që ka shkolla. - Nxënësi mund të përzgjedhë deri në 2 (dy) klube të arteve dhe zejeve, sipas menuesë së ofruar nga shkolla.

	- Nxënësit kanë detyrimin të ndjekin rregullisht klubet e përzgjedhura deri në përfundim të vitit shkollor. - Klubet KAZ shtrihen gjatë gjithë javës nga dita e hënë deri ditën e premte. Nxënësi ndjek programin Pas shkolle në ditët që zhvillohen klubet KAZ që ai frekuenton. - Një klub zhvillohet 2 herë në javë me nga një orë në ditë. Ora është 60 minutëshe. - Klubet drejtohen nga trajnues me formim ose përvojë në fushën përkatëse. - Një klub mund të përfshijë 20-30 nxënës.
--	--

SHËNIM:

Modele (shembuj) për organizimin e orarit ditor dhe kalendarit javor të programit "Pas shkolle" për klasat VI-IX gjenden në Shtojcën 2, në fund të këtij dokumenti. Këto modele janë orientuese. Shkollat kanë lirinë të planifikojnë dhe të organizojnë kalendarët ditorë/javore dhe llojet e aktiviteteve në përshtatje me veçoritë e nxënësve, nevojat, prirjet dhe interesat e tyre, kushtet/mundësitë e shkollës.

3.3 PROGRAMI "PAS SHKOLLE" NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË (AML)

Në arsimin e mesëm të lartë (AML), klasat X-XII, programi "Pas Shkolle" zhvillohet nëpërmjet klubeve të cilat synojnë të mbështesin zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve, duke nxitur krijimtarinë, talentin, bashkëpunimin, iniciativën dhe pjesëmarrjen aktive në jetën e shkollës dhe të komunitetit.

Përmes veprimtarive të klubeve, nxënësit kanë mundësi të zhvillojnë aftësi krijuese, komunikuese dhe bashkëpunuese, të punojnë në projekte, të shprehin interesat dhe prirjet e tyre, si dhe të forcojnë përgjegjësinë, pavarësinë dhe qytëtarinë aktive. Veprimtaritë e klubeve kontribuojnë gjithashtu në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për jetën, vijimin e studimeve dhe përgatitjen për botën e punës.

Programi "Pas shkolle" organizohet gjatë javës mësimore, jashtë orarit të detyruar të mësimi.

Programi "Pas shkolle" në arsimin e mesëm të lartë (AML) organizohet nëpërmjet Klubeve të Arteve dhe Zejeve (KAZ).

Regjistrimi dhe pjesëmarrja e nxënësve

Pjesëmarrja e nxënësve në veprimtaritë e programit është vullnetare dhe realizohet me pëlqimin e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, për nxënësit nën moshën 18 vjeç.

Pjesëmarrja e nxënësve në program bëhet mbi bazën e kërkesës së personit që ushtron përgjegjësinë prindërore, përmes aplikimit në SMIP.

Krijimi i grupeve të nxënësve

Grupet e nxënësve krijohen në përputhje me standardet, numrin minimal 20 nxënës dhe numrin maksimal 30 nxënës pjesëmarrës, sipas përcaktimeve në urdhrin e ministrit përgjegjës për arsimin.

Regjistrimi i trajnuesve

Shprehja e interesit, përzgjedhja dhe angazhimi i trajnuesve në Programin "Pas Shkolle" realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse.

Menaxhimi i monitorimit për zbatimin e programit

Drejtori/Nëndrejtori i institucionit arsimor publik organizon dhe koordinon zbatimin e Programit "Pas Shkolle".

Drejtori i institucionit arsimor miraton grupet e nxënësve dhe orarin e zhvillimit të

veprimtarive, si dhe siguron kushtet e nevojshme për realizimin e programit.

Trajnuesi raporton në Drejtorinë e shkollës, aktivitetet e zhvilluara në kuadër të programit, si dhe evidenton pjesëmarrjen e nxënësve.

Të dhënat për organizimin e programit, pjesëmarrjen e nxënësve, angazhimin e trajnuesve dhe realizimin e veprimtarive administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) dhe përdoren për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e Programit "Pas Shkolle".

3.3.1 Përshkrimi i përmbajtjes së programit "Pas shkolle" në arsimin e mesëm të lartë

Programi "Pas shkolle" në arsimin e mesëm të lartë (AML) organizohet nëpërmjet Klubeve të Arteve dhe Zejeve (KAZ).

Klubet e arteve dhe zejeve përfshijnë:

- Klubi i muzikës
 - Klubi i teatrit
 - Klubi i artit pamor
 - Klubi i kërcimit
 - Klubi i zejeve
- Shkolla duhet të hapë minimalisht 2 klube.
 - Një klub hapet me minimumi 20 nxënës dhe maksimumi 30 nxënës.
 - Nxënësi mund të përzgjedhë deri në 2 (dy) nga klubet e arteve dhe zejeve, bazuar në interesat dhe prirjet e tij.
 - Shkolla përgatit orarin përkatës në varësi të klubeve të krijuara.
 - Klubet, sipas specifikave përkatëse dhe në varësi të prioritetëve, mund të planifikojnë 2 herë në vit aktivitete në nivel shkolle (konkurse, ekspozitë, shfaqje, panairë etj.), si dhe një herë në vit aktivitete në nivel ZVAP-i ose më gjerë.
 - Klubet e arteve dhe të zejeve drejtohen nga trajnues, në varësi të llojit të klubit, të përzgjedhur sipas legjislacionit përkatës.
 - Trajnuesi i KAZ-së, për ciklin e AML zhvillon vetëm një Klub/Grup për 1 orë në ditë nga 60 minuta x 2 herë në javë).

3.3.2 Organizimi i programit "Pas shkolle" në AML

Në arsimin e mesëm të lartë (AML), programi "Pas shkolle" organizohet përmes

klubeve Arte dhe Zeje (KAZ).

Orari i veprimtarive planifikohet jashtë procesit të detyruar mësimor dhe përshtatet me kushtet specifike të çdo shkolle. Organizimi fleksibël synon të sigurojë pjesëmarrje të qëndrueshme të nxënësve, të nxisë krijimtarinë, bashkëpunimin dhe zhvillimin e aftësive praktike, artistike e sociale, duke u krijuar atyre një mjedis tërheqës për shprehjen e interesave dhe talenteve.

Kohëzgjatja

- Programi “Pas shkolle” në arsimin e mesëm të lartë (AML) zhvillohet përmes klubeve “Arte dhe zeje” (KAZ), pas përfundimit të mësimit të rregullt, deri rreth orës 15:00, në varësi të orarit mësimor dhe organizimit të shkollës.
- Programi në AML organizohet në përputhje me interesat e nxënësve, kushtet dhe burimet njerëzore të shkollës.
- Çdo klub zhvillohet 2 orë në javë, nga 60 minuta secili, në dy ditë të ndryshme.
- Nxënësi përzgjedh klubin sipas interesave dhe prirjeve të tij.
- Shkolla harton orarin e klubeve duke shmangur mbivendosjen me mësimin e detyruar dhe duke marrë parasysh numrin e nxënësve, hapësirat, materialet dhe burimet njerëzore në dispozicion.
- Plani mësimor i mësimit të rregullt i miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, i cili përcakton ngarkesën javore dhe ditore për secilën klasë, merret parasysh gjatë hartimit të orarit të programit. Për këtë arsye, koha e fillimit dhe ditët e zhvillimit të klubeve mund të ndryshojnë sipas klasave dhe organizimit të shkollës.

3.3.3 Modele të planifikimit të përmbajtjes së programit “Pas shkolle” në AML

<i>Programi “Pas shkolle”</i>	
<i>Pushim rekreativ</i>	
<i>Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ)</i>	- Klubet e arteve dhe zejeve organizohen nga shkolla, në varësi të interesave dhe nevojave të nxënësve, si dhe të mundësive që ka shkolla. - Nxënësi mund të përzgjedhë deri në 2 (dy) klube të arteve dhe zejeve, sipas menuse së ofruar nga shkolla. - Klubet KAZ shtrihen gjatë gjithë javës nga dita e hënë deri

	ditën e premte. Nxënësi ndjek programin Pas shkolle në ditët që zhvillohen klubet KAZ që ai frekuenton. - Nxënësit kanë detyrimin të ndjekin rregullisht klubet e përzgjedhura deri në përfundim të vitit shkollor. - KAZ zhvillohet nga dita e hënë deri ditën e premte. - Një klub zhvillohet 2 herë në javë me nga një orë në ditë. Ora është 60 minutëshe. - Klubet drejtohen nga trajnues me formim ose përvojë në fushën përkatëse. - Një klub mund të përfshijë 20-30 nxënës.
--	---

SHËNIM:

Modele (shembuj) për organizimin e orarit ditor dhe kalendarit javor të programit "Pas shkolle" për klasat X-XII gjenden në Shtojcën 3, në fund të këtij dokumenti. Këto modele janë orientuese. Shkollat kanë lirinë të planifikojnë dhe të organizojnë kalendarët ditorë/javore dhe llojet e aktiviteteve në përshtatje me veçoritë e nxënësve, nevojat, prirjet dhe interesat e tyre, kushtet/mundësitë e shkollës.

IV. MENAXHIMI NË INSTITUCIONIN ARSIMOR I PROGRAMIT “PAS SHKOLLE”



4.1 Zbatimi i programit “Pas shkollë”

- Programi “Pas shkollë” do të zhvillohet pas përfundimit orarit të detyruar mësimor. Në shkollat ku do të zbatohet programi, nxënësit do të zhvillojnë mësim me orar të rregullt dhe me të njëjtat lëndë si në shkollat e tjera sipas orarit mësimor. Pas orarit mësimor, vazhdohet me programin “Pas shkollë”.
- Koha e nisjes dhe përfundimit të këtij programi ndryshon sipas klasave (p.sh, klasa e dytë përfundon procesin mësimor më shpejt se klasa e tretë).
- Aktivitetet që shkolla organizon në kuadër të programit “Pas shkollë” duhet të sigurojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve, duke bërë kujdes të veçantë për integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta dhe zhvillimin e talenteve.
- Pjesëmarrja në programin “Pas shkollë” në arsimin fillor përfshin ndjekjen njëkohësisht të dy komponentëve të tij: BDSH dhe KAZ, ndërsa në AMU dhe AML programi përfshin klubet KAZ.
- Nxënësi nuk vlerësohet me notë për programin “Pas shkollë”.
- Shkollat zhvillojnë programin “Pas shkollë” duke u kujdesur të respektojnë rregullat e higjienës dhe sigurisë.
- Përfshirja e prindërve në programin “Pas shkollë”. Angazhimi i prindërve në programin “Pas shkollë” ndikon në përmirësimin e arritjeve të fëmijës së tyre dhe pjesëmarrja e tyre në aktivitete të ndryshme ndihmon në arritjen e rezultateve të kërkuara.
- Programi “Pas shkollë” nuk cënon zhvillimin e programeve të tjera, si Shkolla qendër komunitare, Toka në Shkollë etj.
- Programi “Pas Shkollë” nuk kufizon dhe nuk përjashton organizimin e veprimtarive të tjera plotësuese dhe jashtëshkollore, projekteve, partneriteteve dhe nismave edukative, kulturore, sportive apo sociale, të zhvilluara nga institucionet arsimore në bashkëpunim me institucione publike, organizata të shoqërisë civile, partnerë zhvillimi ose subjekte të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- “Bëjmë Detyrat e Shtëpisë” (BDSH), zhvillohet nga trajnues të diplomuar në fushën e mësuesisë apo në fusha të përafërta në një program të ciklit të dytë të studimeve, në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë apo institucione të huaja të

arsimit të lartë, për të cilin është njohur dhe njësuar diploma e huaj bazuar në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

- Klubet e Arteve dhe Zejeve (KAZ), zhvillohen nga trajnues të diplomuar në fushën e mësuesisë apo në programe studimi të ngjashme ose të përafërta me fushën/lëndën e mësimdhënies në profilet artistike, në institucione të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë apo institucione të huaja të arsimit të lartë, për të cilin është njohur dhe njësuar diploma e huaj bazuar në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

4.2 Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e programit “Pas shkolle”

a) Drejtoria e institucionit arsimor ku zbatohet programi “Pas shkolle”:

- Menaxhon dhe organizon programin “Pas shkolle”. Njëri nga drejtuesit e shkollës ngarkohet të jetë në dispozicion dhe të koordinojë aktivitetet për zbatimin e kalendarit të programit “Pas shkolle”, duke riorganizuar detyrat dhe funksionet e tij për menaxhimin e këtij programi.
- Harton planin vjetor për organizimin dhe zhvillimin e Programit “Pas Shkolle” në institucionin arsimor, në përputhje me standardet dhe planin e veprimit të miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin.
- Drejtori i institucionit arsimor shqyrton dhe miraton planet mujore të aktiviteteve të mësuesve/trajnuesve të angazhuar në programin “Pas shkolle” dhe ndjek zbatimin e tyre.
- Siguron një klimë bashkëpunimi dhe miqësore për zbatimin e programit “Pas shkolle”.
- Cakton, në bashkëpunim me ZVAP-në përkatëse, mësuesit/trajnuesit që do të angazhohen për zhvillimin e aktiviteteve të këtij programi.
- Monitoron ecurinë e realizimit të programit “Pas shkolle”.
- Në bashkëpunim me mësuesit/trajnuesit e angazhuar, Bordin e shkollës, përfaqësues të Këshillit të prindërve kujdesen për sigurimin dhe organizimin e mjediseve/hapësirave në të cilat do të zhvillohen aktivitetet.
- Merr masa të krijojë në institucionin arsimor dhe të përditësojë këndin e programit “Pas shkolle” në të cilin përfshihen menuja e aktiviteteve që ofrohen në këtë program, foto nga aktivitete të realizuara, produkte të realizuara nga nxënësit në kuadër të këtij programi etj.
- Në bashkëpunim me mësuesit/trajnuesit e angazhuar në këtë program, përgatisin

kalendarin e zhvillimit të aktiviteteve, të cilin e ekspozojnë në këndin e programit "Pas shkolle".

- Në bashkëpunim me mësuesit kujdestarë dhe mësuesit e angazhuar për programin "Pas shkolle", zhvillojnë seanca informuese me nxënësit dhe prindërit për njohjen e programit dhe përzgjedhjen e aktiviteteve që dëshirojnë të ndjekin.
- Në bashkëpunim me mësuesit e angazhuar për programin "Pas shkolle", zhvillojnë seanca informuese me përfaqësues të pushtetit lokal, përfaqësues të institucioneve të artit, të kulturës, të trashëgimisë kulturore, përfaqësues të aktiviteteve artizanale etj., për njohjen e programit dhe sigurimin e bashkëpunimit për mbështetjen e aktiviteteve të këtij programi.
- Ofron dhe siguron mbështetje në dispozicion të mësuesve/trajnuesve për mbarëvajtjen e aktiviteteve të programit.
- Analizon raportet mujore të ecurisë së procesit dhe merr masa për zgjidhjen e problemeve.
- Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me organet kolegjiale në shkollë, ZVAP-të përkatëse dhe pushtetin vendor.

b) Mësuesit/trajnuesit e angazhuar për zhvillimin e aktiviteteve të programit "Pas shkolle":

- Mësuesit e arsimit fillor, trajnuesit e arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë të angazhuar për zhvillimin e programit "Pas shkolle" përgatisin çdo muaj planin mujor të aktiviteteve dhe e dorëzojnë në drejtorinë e shkollës në fillim të muajit.
- Mësuesit/trajnuesit mbajnë shënim frekuentimin ditor të nxënësve për programin "Pas shkolle".
- Në fund të muajit mësuesit/trajnuesit e angazhuar përgatisin raportin mujor për realizimin e aktiviteteve sipas planit dhe e dorëzojnë në drejtorinë e shkollës.
- Plani i aktiviteteve dhe realizimi i tij dorëzohen nga mësuesi/trajnuesi te drejtuesi i shkollës që koordinon aktivitetet e programit "Pas shkolle".

c) Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP):

- Angazhon mësuesit/trajnuesit për zhvillimin e orëve përkatëse në programin "Pas shkolle".
- Mbështet dhe këshillon institucionet arsimore për çështje të ndryshme që lidhen me zbatimin dhe mbarëvajtjen e programit "Pas shkolle".

- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e zbatimit të programit “Pas shkolle” në institucionet arsimore ku ajo zbatohet.
- Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) për nevojat që lidhen me zbatimin e programit.
- Cakton një koordinator në nivel ZVAP që ndjek programin “Pas shkolle”.
- Koordinator i ZVAP grumbullon raportet mujore të institucioneve arsimore dhe përgatit raportin mujor përmbledhës të ecurisë së zbatimit të programit të cilin e dorëzon në DRAP-in përkatës.
- Koordinator i ZVAP mbledh të dhënat nga shkollat dhe krijon databazën e klubeve të Arteve dhe Zejeve, të klubeve të tjera pas shkolle dhe të aktiviteteve të realizuara në kuadër të programit “Pas shkolle”, numrin e nxënësve që ndjekin klubet etj., dhe i dorëzon në DRAP-in përkatës.

d) Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP)

- Mbështet dhe këshillon ZVAP-et përkatëse për çështje të ndryshme që lidhen me zbatimin dhe mbarëvajtjen e programit “Pas shkolle”.
- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e zbatimit të programit “Pas shkolle” në ZVAP-të përkatëse dhe institucionet arsimore ku ajo zbatohet.
- Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me AKAP, ASCAP dhe Ministrinë e Arsimit për nevojat që lidhen me zbatimin e programit.
- Grumbullon raportet mujore të ZVAP-ve përkatëse dhe përgatit raportin mujor përmbledhës të ecurisë së zbatimit të programit të cilin e dorëzon në AKAP.
- Mbledh të dhënat nga ZVAP-et dhe krijon databazën e klubeve të Arteve dhe Zejeve, të klubeve të tjera pas shkolle, të aktiviteteve të realizuara në kuadër të programit “Pas shkolle”, numrin e nxënësve që ndjekin klubet etj., dhe i dorëzon në AKAP.

e) Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)

- Mbështet dhe këshillon DRAP-et përkatëse për çështje të ndryshme që lidhen me zbatimin dhe mbarëvajtjen e programit “Pas shkolle”.
- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e zbatimit të programit “Pas shkolle” në DRAP-et përkatëse dhe institucionet arsimore ku ajo zbatohet.
- Vlerëson nëpërmjet pyetësorëve për të matur kënaqësinë e nxënësve, si pjesë e "përmirësimit të cilësisë".
- Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me MA për nevojat që lidhen me zbatimin

e programit.

- Grumbullon raportet mujore të DRAP-ve përkatëse sipas formateve të unifikuara dhe përgatit raportin mujor përmbledhës të ecurisë së zbatimit të programit të cilin e dorëzon në MA.
- Mbledh të dhënat nga DRAP-et dhe krijon databazën e klubeve të Arteve dhe Zejeve, të aktiviteteve të realizuara në kuadër të programit “Pas shkolle”, numrin e nxënësve që ndjekin klubet etj., dhe i dorëzon në MA.

f) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)

- Mbështet dhe këshillon DRAP-et përkatëse për çështje të ndryshme që lidhen me zbatimin dhe mbarëvajtjen e programit “Pas shkolle”.
- Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me MA për nevojat që lidhen me zbatimin e programit.
- Harton materiale mbështetëse dhe module trajnimi për mësuesit për zbatimin sa më efektiv të programit “Pas shkolle”.
- Ngre kapacitete dhe organizon zhvillimin profesional të mësuesve për zbatimin sa më cilësor të programit “Pas shkolle”.

V. SHTOJCA



Shtojca 1: Modele të orarit ditor dhe të kalendarit javor për programin “Pas shkolle” për Arsimin fillor (klasat I-V)

1.1. Modele të orarit ditor për programin “Pas shkolle” për klasat I-V

Tabela 1. Model i një orari të programit “Pas shkolle” për klasat I-III, për ditët kur orari mësimor mbaron në orën 11.30.

Varianti 1

Orari	Klasa I-III
11.30– 12.30	KAZ
12.30-13.00	Dreka (Pushim)
13.00-14.00	BDSH
14.00	Përcjellja e nxënësve

Varianti 2

Orari	Klasa I-III
11.30– 12.30	BDSH
12.30-13.00	Dreka (Pushim)
13.00-14.00	KAZ
14.00	Përcjellja e nxënësve

Tabela 2. Model i një orari të programit “Pas shkolle” për klasat I-III, për ditët kur orari mësimor mbaron në orën 12.20.

Varianti 1

Orari	Klasa I-III
12.20 – 13.00	Dreka (Pushim)
13.00 – 14.00	KAZ
14.00-15.00	BDSH

15.00	Përcjellja e nxënësve
-------	-----------------------

Varianti 2

Orari	Klasa I-III
12.20 – 13.00	Dreka (Pushim)
13.00 – 14.00	BDSH
14.00-15.00	KAZ
15.00	Përcjellja e nxënësve

Tabela 3. Model i një orari të programit “Pas shkolle” për klasat IV-V

Varianti 1

Orari	Klasa IV-V
12.20– 13.00	Dreka (Pushim)
13.00-14.00	KAZ
14.00-15.00	BDSH
15.00	Përcjellja e nxënësve

Varianti 2

Orari	Klasa IV-V
12.20– 13.00	Dreka (Pushim)
13.00-14.00	BDSH
14.00-15.00	KAZ
15.00	Përcjellja e nxënësve

1.2. Modele të kalendarit javor për programin “Pas shkolle” për klasat I-III

Tabela 4. Modeli i një kalendarit javor për programin “Pas Shkolle” për klasat I-III, kur orari mësimor mbaron në orën 11.30.

Dita	Orari	Veprimtaritë
<i>E hënë</i>	11.30– 12.30	KAZ (Muzikë; Art pamor)
	12.30-13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	BDSH
	14.00	Përcjellja e nxënësve
	11.30– 12.30	KAZ (Teatër; Kërcim)

<i>E martë</i>	12.30-13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	BDSH
	14.00	Përcjellja e nxënësve
<i>E mërkurë</i>	11.30- 12.30	KAZ (Muzikë; Art pamor)
	12.30-13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	BDSH
	14.00	Përcjellja e nxënësve
<i>E enjte</i>	11.30- 12.30	KAZ (Teatër; Kërcim)
	12.30-13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	BDSH
	14.00	Përcjellja e nxënësve
<i>E premte</i>	11.30- 12.30	KAZ (Zeje)
	12.30-13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	BDSH
	14.00	Përcjellja e nxënësve
Shënim: Shembulli i mësipërm është një model i organizimit të një kalendari javor të programit “Pas shkolle”. Shkollat kanë lirinë të planifikojnë dhe organizojnë kalendaret ditore/javore dhe llojet e aktiviteteve në përshtatje me veçoritë e nxënësve, nevojat, prirjet dhe interesat e tyre si dhe kushteve/mundësive të shkollës.		

Tabela 5. Modeli i një kalendari javor për programin “Pas Shkolle” për klasat IV-V, kur orari mësimor mbaron në orën 12.20.

Dita	Orari	Veprimtaritë
<i>E hënë</i>	12.20- 13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	KAZ (Muzikë; Art pamor)
	14.00-15.00	BDSH
	15.00	Përcjellja e nxënësve
<i>E martë</i>	12.20- 13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	KAZ (Teatër, Kërcim)
	14.00-15.00	BDSH
	15.00	Përcjellja e nxënësve
<i>E mërkurë</i>	12.20- 13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	KAZ (Muzikë; Art pamor)
	14.00-15.00	BDSH
	15.00	Përcjellja e nxënësve

<i>E enjte</i>	12.20–13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	KAZ (Teatër, Kërcim)
	14.00-15.00	BDSH
	15.00	Përcjellja e nxënësve
<i>E premte</i>	12.20– 13.00	Dreka (Pushim)
	13.00-14.00	KAZ (Zeje)
	14.00-15.00	BDSH
	15.00	Përcjellja e nxënësve
Shënim: Shembulli i mësipërm është modeli i organizimit të një kalendari javor të programit "Pas shkolle". Shkollat kanë lirinë të planifikojnë dhe të organizojnë kalendaret ditore/javore dhe llojet e aktiviteteve në përshatje me veçoritë e nxënësve, nevojat, prirjet dhe interesat e tyre si dhe kushteve/mundësive të shkollës.		

Shtojca 2: Modele të orarit ditor dhe të kalendarit javor për programin “Pas shkolle” për Arsimin e mesëm të ulët (klasat VI-IX)

2.1. Modele të orarit ditor për programin “Pas shkolle” për klasa VI-IX

Tabela 1. Model i një orari ditor i programit “Pas shkolle” për klasat VI-IX, kur mësimi mbaron në orën 13.10.

Orari	Klasa VI-IX	
	Klubi 1	Klubi 2
13.10– 13.30	Pushim	
13.30-14.30	KAZ (Teatër)	KAZ (Kërcim)
14.30-15.00	Përcjellja e nxënësve	

Tabela 2. Model i një orari ditor i programit “Pas shkolle” për klasat VI-IX, kur orari mësimor mbaron në orën 14.00.

Orari	Klasa VI-IX	
	Klubi 1	Klubi 2
14.00- 15.00	KAZ (Teatër)	KAZ (Kërcim)
15.00	Përcjellja e nxënësve	

Në arsimin e mesëm të ulët (AMU), brenda një dite mund të zhvillohen paralelisht deri në dy klube të ndryshme, në të njëjtin interval kohor, secili i drejtuar nga një trajnues i profilit përkatës.

2.2. Modele të kalendarit javor për programin “Pas shkolle” për klasa VI-IX

Tabela 3. Model i një kalendarit javor për programin “Pas shkolle” për klasat VI-IX

Dita	Menuja që ofron shkolla brenda një jave	
E hënë	KAZ (Klubi i muzikës)	KAZ (Klubi i artit pamor)
E martë	KAZ (Klubi i teatrit)	KAZ (Klubi i kërcimit)
E mërkurë	KAZ (Klubi i muzikës)	KAZ (Klubi i artit pamor)

E enjte	KAZ (Klubi i teatrit)	KAZ (Klubi i kërcimit)
E premte	KAZ (Zeje)	

Shënim: Shembulli i mësipërm paraqet një model orientues të kalendarit javor dhe të menisë së klubeve që mund të ofrohen në kuadër të programit “Pas shkolle”. Në arsimin e mesëm të ulët (AMU), brenda një dite mund të zhvillohen paralelisht deri në dy klube të ndryshme, në të njëjtin interval kohor, nga trajnues të profileve përkatëse. Klubet organizohen sipas një kalendarit javor, në mënyrë që secili klub të zhvillohet dy herë në javë. Shkollat kanë fleksibilitet në përcaktimin e klubeve, të kalendarit ditor dhe javor, si edhe të kombinimit të tyre, në përputhje me moshën, nevojat, prirjet dhe interesat e nxënësve, si edhe me kushtet, burimet dhe mundësitë që kanë në dispozicion.

Shtojca 3: Modele të orarit ditor dhe të kalendarit javor për programin “Pas shkolle” për Arsimin e mesëm të lartë (klasat X-XII)

3.1. Modele të orarit ditor për programin “Pas shkolle” për klasa X-XII

Tabela 1. Model i një orari ditor i programit “Pas shkolle” për klasat X-XII, kur mësimi mbaron në orën 13.10.

Orari	Klasa X-XII	
	Klubi 1	Klubi 2
13.10– 13.30	Pushim	
13.30-14.30	KAZ (Muzikë)	KAZ (Art pamor)
14.30-15.00	Përcjellja e nxënësve	

Tabela 2. Model i një orari ditor i programit “Pas shkolle” për klasat X-XII, kur mësimi mbaron në orën 14.00.

Orari	Klasa X-XII	
	Klubi 1	Klubi 2
14.00- 15.00	KAZ (Muzikë)	KAZ (Art pamor)
15.00	Përcjellja e nxënësve	

Në arsimin e mesëm të lartë (AML), brenda një dite mund të zhvillohen paralelisht deri në dy klube të ndryshme, në të njëjtin interval kohor, secili i drejtuar nga një trajnues i profilit përkatës.

Modele të kalendarit javor për programin “Pas shkolle” për klasa X-XII

Tabela 3. Model i një kalendari javor për programin “Pas shkolle” për klasat X-XII

Dita	Menuja që ofron shkolla brenda një jave	
E hënë	KAZ (Klubi i muzikës)	KAZ (Klubi i kërcimit)
E martë	KAZ (Klubi i artit pamor)	KAZ (Klubi i teatrit)
E mërkurë	KAZ (Klubi i muzikës)	KAZ (Klubi i kërcimit)

E enjte	KAZ (Klubi i artit pamor)	KAZ (Klubi i teatrit)
E premte	KAZ (Zeje)	

Shënim: Shembulli i mësipërm paraqet një model orientues të kalendarit javor dhe të menisë së klubeve që mund të ofrohen në kuadër të programit “Pas shkolle”. Në arsimin e mesëm të lartë (AML), brenda një dite mund të zhvillohen paralelisht deri në dy klube të ndryshme, në të njëjtin interval kohor, nga trajnues të profileve përkatëse. Klubet organizohen sipas një kalendarit javor, në mënyrë që secili klub të zhvillohet dy herë në javë. Shkollat kanë fleksibilitet në përcaktimin e klubeve, të kalendarit ditor dhe javor, si edhe të kombinimit të tyre, në përputhje me moshën, nevojat, prirjet dhe interesat e nxënësve, si edhe me kushtet, burimet dhe mundësitë që kanë në dispozicion.

Shtojca 4: Modele të angazhimit të trajnuesit të BDSH dhe KAZ në programin “Pas shkolle”

Oraret e paraqitura në këtë shtojcë janë orientuese dhe i referohen modeleve të organizimit të orarit ditor të programit “Pas shkolle”, të paraqitura në Shtojcat 1, 2 dhe 3 për secilin nivel arsimor. Ato mund të përshtaten nga shkolla në përputhje me organizimin e programit, kushtet konkrete të institucionit arsimor dhe mundësitë e angazhimit të mësuesve/trajnuesve.

1. Modele të angazhimit të trajnuesit/mësuesit të BDSH

Varianti 1: Kur mësuesi është i angazhuar me një grup BDSH (p.sh., për klasat I-III)

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
Grupi 1	11.30-12.30	11.30-12.30	11.30-12.30	11.30-12.30	11.30-12.30

Varianti 2: Kur mësuesi është i angazhuar me 2 grupe BDSH (p.sh., për klasat I-III dhe IV-V)

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
Grupi 1	11.30-12.30	11.30-12.30	11.30-12.30	11.30-12.30	11.30-12.30
Grupi 2	13.00-14.00	13.00-14.00	13.00-14.00	13.00-14.00	13.00-14.00

2. Modele të angazhimit të trajnuesit/mësuesit të BDSH

Varianti 1: Kur trajnuesi i një klubi (p.sh., muzikë) është i angazhuar në një institucion arsimor, në të dy nivelet arsimore (AF + AMU).

KLUBI	Institucioni 1	
	E hënë	E mërkurë
Klubi KAZ në AF (klasat I-III)	11.30-12.30	11.30-12.30
Klubi KAZ në AF (klasat IV-V)	13.00-14.00	13.00-14.00
Klubi KAZ në AMU (klasat VI-IX)	14.00-15.00	14.00-15.00

Varianti 2: Kur trajnuesi i një klubi (p.sh., muzikë) është i angazhuar në dy institucione arsimore 9-vjeçare (AF + AMU) + (AF + AMU).

KLUBI	Institucioni 1		Institucioni 2	
	E hënë	E mërkurë	E martë	E enjte

Klubi KAZ në AF (klasat I-III)	11.30-12.30	11.30-12.30	11.30-12.30	11.30-12.30
Klubi KAZ në AF (klasat IV-V)	13.00-14.00	13.00-14.00	13.00-14.00	13.00-14.00
Klubi KAZ në AMU (klasat VI-IX)	14.00-15.00	14.00-15.00	14.00-15.00	14.00-15.00

Varianti 3: Kur trajnuesi i një klubi (p.sh., muzikë) është i angazhuar në dy institucione arsimore, 9-vjeçar (AF +AMU) dhe gjimnaz (AML).

Institucioni 1			Institucioni 2		
KLUBI	E hënë	E mërkurë	KLUBI	E martë	E enjte
Klubi KAZ në AF (klasat I-III)	11.30-12.30	11.30-12.30	Klubi KAZ në AML (klasat X-XII)	14.00-15.00	14.00-15.00
Klubi KAZ në AF (klasat IV-V)	13.00-14.00	13.00-14.00			
Klubi KAZ në AMU (klasat VI-IX)	14.00-15.00	14.00-15.00			

Varianti 4: Kur trajnuesi i një klubi (p.sh., muzikë) është i angazhuar në dy institucione arsimore, 9-vjeçar (AMU) dhe gjimnaz (AML).

Institucioni 1			Institucioni 2		
KLUBI	E hënë	E mërkurë	KLUBI	E martë	E enjte
Klubi KAZ në AMU (klasat VI-IX)	13.30-14.30	13.30-14.30	Klubi KAZ në AML (klasat X-XII)	14.00-15.00	14.00-15.00

VI. BIBLIOGRAFI



- Udhërrëfyes për zbatimin e programit pas shkollës dhe shkollave verore në arsimin bazë në Republikën e Shqipërisë, MAS, UNICEF, 2025.
- https://www.moec.gov.cy/dde/en/public_summer_schools.html
- <https://pianoestate.static.istruzione.it/il-piano.html>
- <https://www.citizensinformation.ie/en/education/special-education-needs/summer-education-programme/#:~:text=All%20primary%20schools%20and%20post,c,an%20provide%20a%20Summer%20Programme>
- <https://education.ec.europa.eu/>
- <https://eurydice.eacea.ec.europa.eu/>
- <https://www.gov.uk/government/organisations/departement-for-education>
- <https://www.gov.uk/government/collections/national-tutoring-programme-funding>
- <https://www.gov.uk/government/publications/summer-schools-programme/summer-schools-guidance>
- Eurofound (2020), Out-of-school care: Provision and public policy, Publications Office of the European Union, Luxembourg.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

Shtojca nr. 2

PLANI I VEPRIMIT

PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT “PAS SHKOLLE”

2026

Nr.	Veprimtaritë	Afati	Institucioni përgjegjës
1.	Ngritja e urdhrit të MA për zbatimin e programit “Pas shkolle”.	Korrik 2026	MA
2.	Përzgjedhja e shkollave që do të zbatojnë programin “Pas shkolle” sipas kritereve të miratuara.	Gusht 2026	MA, AKAP
3.	Përgatitja e rubrikës pas shkolle nga AKSHI, për aplikim dhe raportim. - Përgatitja e databazës së klubeve, në SMIP sipas niveleve arsimore AF, AMU dhe AML. - Aplikimi në sistem nga prindërit ose personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. - Aplikimi nga mësues/trajnues në sistem.	Gusht 2026	AKSHI, MA
4.	Aplikimi dhe përzgjedhja e trajnerëve që do të zhvillojnë programin “ Pas shkolle” (mësues për BDSH në AF si dhe trajnues sipas llojit të klubit në AF, AMU dhe AML) dhe raportimi në MA.	Shtator 2026 java 1- 2	AKAP
5.	Aplikimi i nxënësve që do të zhvillojnë programin “Pas shkolle” në SMIP.	Shtator 2026 java 1-2	AKAP, DRAP, ZVAP, Institucionet arsimore
6.	Ndarja e grupeve të nxënësve dhe përcaktimi i mësuesit/trajnuesit. Përgatitja e databazës përmbledhëse për numrin e grupeve dhe raportimi nga AKAP në MA.	Shtator 2026 java 3	AKAP, DRAP, ZVAP, Institucionet arsimore
7.	Hartimi i kalendarit nga Drejtuesi i institucionit arsimor, për çdo shkollë zbatuese të programit “Pas shkolle” dhe raportimi nga AKAP në MA.	Shtator 2026 java 3-4	AKAP, DRAP, ZVAP, Institucionet arsimore
8.	Trajnimi i trajnuesve për zhvillimin e programit “Pas shkolle”.	Shtator 2026 java 3-4, proces në vijimësi	ASCAP, AKAP

9.	Fillimi i zbatimit të programit “ Pas shkolle”.	1 Tetor 2026	MA, AKAP, DRAP, ZVAP, Institucionet arsimore
10.	Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të programit “Pas Shkolle” në fund të çdo periudhe dhe raportimi në MA.	Dhjetor 2026, Mars 2027, Qershor 2027	MA, AKAP, DRAP, ZVAP, Institucionet arsimore
11.	Raportimi periodik për çdo periudhë mësimore mbi mbarëvajtjen e programit “Pas shkolle” dhe raportimi në MA.	Dhjetor 2026, Mars 2027, Qershor 2027	MA, AKAP, DRAP, ZVAP, Institucionet arsimore
12.	Monitorimi i zbatimit të programit “ Pas shkolle”.	Gjatë zbatimit	MA, AKAP, DRAP, ZVAP



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Shtojca nr. 3

**STANDARDET PËR
ORGANIZIMIN DHE
ZHVILLIMIN E PROGRAMIT
“PAS SHKOLLE”**

2026

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
QËLLIMI I STANDARDEVE	5
PARIMET E PROGRAMIT "PAS SHKOLLE"	5
STRUKTURA E STANDARDEVE.....	7
FUSHAT, STANDARDET DHE TREGUESIT	9
FUSHA I: MIRËQENIA, SIGURIA DHE MBROJTJA E NXËNËSVE.....	9
FUSHA II: GJITHËPËRFSHIRJA DHE PJESËMARRJA	10
FUSHA III: PËRVOJAT E TË NXËNIT DHE AKTIVITETET E PROGRAMIT	11
FUSHA IV: STAFI DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL	12
FUSHA V: BASHKËPUNIMI ME FAMILJEN DHE KOMUNITETIN	13
FUSHA VI: ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE BURIMET E PROGRAMIT	14
FUSHA VII: MONITORIMI, VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI I PROGRAMIT	15
ZBATIMI I STANDARDEVE	16
PËRDORIMI I STANDARDEVE.....	16
PËRGJEGJËSITË PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE.....	16
RISHIKIMI I STANDARDEVE	17
INSTRUMENT ORIENTUES PËR VETËVLERËSIMIN E PROGRAMIT "PAS SHKOLLE"	17
ANEKSI 1	21
FJALORTH.....	21

HYRJE

Programi "Pas Shkolle" është një program edukativ që zgjeron mundësitë e të nxënësve përtej procesit të rregullt mësimor dhe kontribuon në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve. Përmes një oferte të larmishme aktiviteteve edukative, kulturore, artistike, sportive, qytetare dhe rekreative, programi krijon mundësi që nxënësit të zhvillojnë kompetencat, aftësitë, interesat dhe talentet e tyre në një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe motivues.

Në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, Programi "Pas Shkolle" plotëson dhe pasuron përvojat e të nxënësve të ofruara në kurrikulën formale, duke mbështetur zhvillimin e kompetencave kyçe dhe duke promovuar mirëqenien, pjesëmarrjen aktive, bashkëpunimin, krijimtarinë dhe qytetarinë e përgjegjshme. Programi krijon mundësi për zhvillimin personal, social, kulturor dhe qytetar të nxënësve, në përputhje me interesat, nevojat dhe potencialin e tyre.

Programi zhvillohet në një mjedis edukativ të organizuar, ku nxënësit ndërtojnë marrëdhënie pozitive me bashkëmoshatarët, stafin e angazhuar, familjen dhe komunitetin. Përmes bashkëpunimit ndërmjet këtyre aktorëve, ai forcon rolin e institucionit arsimor si qendër e zhvillimit, mirëqenies dhe përfshirjes së fëmijëve dhe të rinjve.

Ky dokument hartohet në zbatim të nenit 47/1 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shtuar me ligjin nr. 26/2026, "Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin nr. 69/2012 'Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar", si dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle".

Zhvillimi i Programit "Pas Shkolle" kërkon një kuadër të përbashkët orientues që të mbështesë institucionet arsimore në planifikimin, organizimin, zhvillimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit, duke respektuar njëkohësisht autonominë e tyre për ta përshtatur ofertën edukative me nevojat e nxënësve, burimet në dispozicion dhe karakteristikat e komunitetit.

Standardet përcaktojnë kërkesat për organizimin dhe zhvillimin cilësor të Programit "Pas shkolle" pas përfshirjes së institucionit arsimor në të. Kriteret për përzgjedhjen e institucioneve arsimore përcaktohen në një dokument ose instrument të veçantë të miratuar nga Ministria e Arsimit.

Standardet për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle" përbëjnë dokumentin bazë orientues për institucionet arsimore dhe strukturat përgjegjëse për organizimin, mbështetjen, monitorimin dhe zhvillimin e programit. Ato përcaktojnë kërkesat themelore për

organizimin dhe zhvillimin cilësor të Programit "Pas Shkolle", duke krijuar një bazë të përbashkët për garantimin e cilësisë, ndërkohë që u japin institucioneve arsimore fleksibilitetin e nevojshëm për të ndërtuar një ofertë edukative në përputhje me interesat dhe nevojat e nxënësve, burimet e disponueshme dhe prioritetet e komunitetit.

Qëllimi i standardeve

Standardet për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle" kanë për qëllim:

- a) të krijojnë një kuadër të përbashkët për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle";
- b) të mbështesin institucionet arsimore në planifikimin, organizimin, dhe zhvillimin cilësor të programit "Pas shkolle";
- c) të garantojnë cilësinë e përvojave edukative, mirëqenien, sigurinë dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve;
- d) të mbështesin zhvillimin e një oferte edukative të larmishme, fleksibël dhe të orientuar drejt nevojave, interesave dhe potencialit të nxënësve;
- e) të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet institucionit arsimor, familjes dhe komunitetit në mbështetje të zhvillimit të Programit "Pas Shkolle";
- f) të orientojnë institucionet arsimore në procesin e vlerësimit, vetëvlerësimit, në përmirësimin e organizimit dhe zhvillimit të Programit "Pas Shkolle".

KAPITULLI I: PARIMET E PROGRAMIT "PAS SHKOLLE"

Programi "Pas Shkolle" mbështetet në konceptin se zhvillimi i gjithanshëm i nxënësve realizohet përmes përvojave të larmishme edukative, të cilat plotësojnë procesin e rregullt mësimor dhe krijojnë mundësi për zhvillimin e kompetencave, aftësive, vlerave dhe talenteve. Organizimi dhe zhvillimi i programit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

A. Përqendrimi te nxënësi

Programi është i hartuar në mënyrë që çdo aktivitet dhe ndërhyrje të jetë e përshtatur me nevojat, interesat dhe potencialin individual të çdo nxënësi. Kjo qasje garanton që mësimi dhe aktivitetet jashtëkurrikulare të jenë të personalizuar, duke krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës që promovon zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve. Duke u bazuar në nevojat specifike të secilit nxënësi, programi synon të rrisë motivimin, angazhimin dhe suksesin akademik dhe personal të tyre.

B. Barazia dhe gjithëpërfshirja

Programi siguron mundësi të barabarta pjesëmarrjeje për të gjithë nxënësit, pavarësisht gjinisë, aftësive, gjuhës, statusit social, ekonomik ose karakteristikave të tjera individuale. Kjo

përfshin eliminimin e pengesave që mund të kufizojnë pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitete, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë. Mbështetja për nxënësit nga grupet vulnerabël është një hapësirë thelbësore për të siguruar që të gjithë të kenë mundësinë të përfitojnë nga programi pa asnjë diskriminim.

C. Partneriteti me familjen dhe komunitetin

Programi inkurajon pjesëmarrjen aktive dhe partneritetet me organizata lokale dhe familjet e nxënësve. Ky bashkëpunim krijon një rrjet mbështetjeje të fortë që kontribuon në suksesin e programit, duke siguruar që të gjitha palët e përfshira të jenë të angazhuara dhe të bashkëpunojnë për të arritur qëllimet e përbashkëta. Përmes këtij bashkëpunimi, programi mobilizon dhe shfrytëzon burimet, ekspertizën dhe potencialin e komunitetit.

D. Zhvillimi i vazhdueshëm dhe përmirësimi i cilësisë

Programi përfshin mekanizma të rregullt për monitorim dhe vlerësim, duke identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim dhe duke marrë masa për të përballuar sfidat. Kjo qasje garanton që programi të mbetet i qëndrueshëm dhe efektiv në kohë, si dhe të jetë në përputhje me praktikat më të mira, duke u përshtatur në bazë të feedback-ut dhe nevojave të ndryshme të nxënësve.

E. Inovacioni dhe krijimtaria

Veprimtaritë nxitin mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve të nxënësit, duke i pajisur ata me aftësi të nevojshme për të përballuar sfidat e shoqërisë bashkëkohore. Kjo përfshin ofrimin e aktiviteteve që inkurajojnë eksplorimin e ideve të reja, krijimin e projekteve inovative dhe bashkëpunimin në grupe, duke krijuar një mjedis ku nxënësit mund të zhvillojnë dhe të zgjerojnë potencialin e tyre.

F. Interesi më i lartë i fëmijës

Programi udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, duke siguruar që çdo vendimmarrje, aktivitet dhe ndërhyrje të ketë në qendër mirëqenien dhe zhvillimin e nxënësve. Në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, programi garanton një mjedis të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës, ku respektohen të drejtat e fëmijëve dhe promovohen dinjiteti, pjesëmarrja dhe zhvillimi i tyre i plotë. Ky parim zbatohet përmes vendimmarrjes që merr në konsideratë nevojat dhe interesat më të mira të nxënësve, si dhe përmes sigurimit të kushteve që mbështesin mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të tyre.

KAPITULLI II: STRUKTURA E STANDARDEVE

Standardet për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle" janë ndërtuar mbi parimet e programit dhe përbëjnë kuadrin orientues për planifikimin, organizimin, zhvillimin, monitorimin, vetëvlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij.


Ato u shërbejnë:

- institucioneve arsimore;
- drejtuesve të institucioneve arsimore;
- stafit të angazhuar në Programin "Pas Shkolle";
- strukturave përgjegjëse të sistemit arsimor;
- Ministrisë së Arsimit.

Standardet janë të organizuara në shtatë fusha, të cilat pasqyrojnë dimensionet kryesore të Programit "Pas Shkolle". Çdo fushë përfshin standarde, ndërsa çdo standard shoqërohet me tregues orientues, të cilët mbështesin institucionet arsimore në zbatimin, monitorimin dhe vetëvlerësimin e programit.

Fusha	Standardet
 Fusha I. Mirëqenia, siguria dhe mbrojtja e nxënësve	1.1 Mirëqenia e nxënësve
	1.2 Siguria dhe mbrojtja e nxënësve
 Fusha II. Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja	2.1 Gjithëpërfshirja
	2.2 Pjesëmarrja aktive e nxënësve
 Fusha III. Përvojat e të nxënit dhe aktivitetet e Programit	3.1 Planifikimi i aktiviteteve të Programit
	3.2 Zhvillimi i aktiviteteve të Programit
 Fusha IV. Stafi dhe zhvillimi profesional	4.1 Kompetencat profesionale të stafit
	4.2 Zhvillimi profesional i stafit
 Fusha V. Bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin	5.1 Bashkëpunimi me familjen
	5.2 Bashkëpunimi me komunitetin
 Fusha VI. Organizimi, drejtimi dhe burimet e Programit	6.1 Organizimi dhe drejtimi i Programit
	6.2 Burimet dhe mjediset e Programit
 Fusha VII. Monitorimi, vlerësimi dhe zhvillimi i Programit	7.1 Monitorimi dhe vlerësimi i Programit
	7.2 Zhvillimi i vazhdueshëm i Programit

KUADRI I STANDARDEVE PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROGRAMIT “PAS SHKOLLE”



KAPITULLI III: FUSHAT, STANDARDET DHE TREGUESIT

FUSHA I: MIRËQENIA, SIGURIA DHE MBROJTJA E NXËNËSVE

Kjo fushë përcakton standardet që sigurojnë mirëqenien, mbrojtjen dhe sigurinë e nxënësve gjatë organizimit dhe zhvillimit të Programit "Pas Shkolle". Programi synon krijimin e një mjedisi edukativ të sigurt, mbështetës dhe pozitiv, që promovon zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve dhe garanton respektimin e të drejtave, dinjitetit dhe mirëqenies së tyre.

Standardi 1.1: Mirëqenia e nxënësve

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" garanton një mjedis edukativ që mbështet mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve, promovon marrëdhënie pozitive dhe krijon kushte që favorizojnë zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

Treguesit:

- 1.1.1. Mjedis edukativ mbështet mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve.
- 1.1.2. Marrëdhëniet ndërmjet nxënësve dhe stafit ndërtohen mbi respektin, mirëbesimin dhe bashkëpunimin.
- 1.1.3. Organizimi i aktiviteteve respekton moshën, ritmet e zhvillimit, interesat dhe nevojat e nxënësve.
- 1.1.4. Aktivitetet zhvillohen në një klimë pozitive që nxit pjesëmarrjen, motivimin dhe zhvillimin personal të nxënësve.
- 1.1.5. Çdo nxënës ndjehet i mirëpritur, i respektuar dhe i vlerësuar gjatë pjesëmarrjes në program.

Standardi 1.2: Siguria dhe mbrojtja e nxënësve

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" organizohet dhe zhvillohet në kushte që garantojnë sigurinë, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të çdo nxënësi, në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

Treguesit:

- 1.2.1. Aktivitetet zhvillohen në kushte që garantojnë sigurinë fizike dhe emocionale të nxënësve.
- 1.2.2. Mjediset dhe organizimi i aktiviteteve respektojnë kërkesat për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijës.
- 1.2.3. Institucioni arsimor krijon kushte që promovojnë respektin reciprok, parandalojnë çdo formë dhune, diskriminimi apo përjashtimi dhe mbështesin një mjedis të sigurt për të gjithë nxënësit.
- 1.2.4. Stafi vepron në përputhje me përgjegjësitë për mbrojtjen dhe mirëqenien e nxënësve.
- 1.2.5. Stafi njih dhe zbaton procedurat për reagimin ndaj emergjencave, aksidenteve, dhunës, bullizmit dhe rasteve të dyshuara të cenimit të sigurisë së fëmijës.

FUSHA II: GJITHËPËRFSHIRJA DHE PJESËMARRJA

Kjo fushë përcakton standardet që garantojnë mundësi të barabarta pjesëmarrjeje për të gjithë nxënësit dhe promovojnë një kulturë gjithëpërfshirëse, ku respektohen diversiteti, individualiteti dhe dinjiteti i çdo nxënësi. Programi krijon kushte që nxisin pjesëmarrjen aktive, bashkëpunimin dhe angazhimin e nxënësve në jetën e programit.

Standardi 2.1: Gjithëpërfshirja

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" garanton mundësi të barabarta pjesëmarrjeje për të gjithë nxënësit, duke respektuar diversitetin, aftësitë, interesat dhe nevojat individuale të secilit.

Treguesit:

- 2.1.1. Programi krijon mundësi të barabarta pjesëmarrjeje për të gjithë nxënësit, pa diskriminim.
- 2.1.2. Organizimi i aktiviteteve merr në konsideratë nevojat, aftësitë dhe karakteristikat e ndryshme të nxënësve.
- 2.1.3. Aktivitetet dhe mjediset e programit janë të përshtatshme për të mbështetur pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve.
- 2.1.4. Përzgjedhja e nxënësve në aktivitete dhe klube realizohet mbi bazën e rregullave transparente dhe pa diskriminim. Aktivitetet, materialet dhe mënyrat e komunikimit përshtaten, kur është e nevojshme, për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Standardi 2.2: Pjesëmarrja aktive e nxënësve

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" krijon mundësi që nxënësit të marrin pjesë aktive në planifikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e aktiviteteve, në përputhje me moshën dhe nivelin e tyre të zhvillimit.

Treguesit:

- 2.2.1. Nxënësit inkurajohen të shprehin mendimet, interesat dhe iniciativat e tyre.
- 2.2.2. Aktivitetet krijojnë mundësi për angazhimin aktiv dhe bashkëpunimin e nxënësve.
- 2.2.3. Programi krijon mundësi që nxënësit të marrin role dhe përgjegjësi në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve, në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre.
- 2.2.4. Mendimet e nxënësve për programin "Pas shkolle" mbledhen periodikisht përmes diskutimeve, pyetësorëve, këshillave të nxënësve ose formave të tjera të përshtatshme për moshën.

FUSHA III: PËRVOJAT E TË NXËNIT DHE AKTIVITETET E PROGRAMIT

Kjo fushë përcakton standardet që lidhen me projektimin, organizimin dhe zhvillimin e përvojave të të nxënit në Programin "Pas Shkolle". Programi ofron një gamë të larmishme aktiviteteve edukative që plotësojnë dhe pasurojnë procesin mësimor, duke mbështetur zhvillimin e kompetencave, aftësive, interesave dhe talenteve të nxënësve.

Standardi 3.1: Planifikimi i aktiviteteve të Programit "Pas shkolle"

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" planifikohet në mënyrë të strukturuar, në përputhje me qëllimin e programit, komponentët e tij, nevojat dhe interesat e nxënësve, si dhe karakteristikat e institucionit arsimor.

Treguesit:

- 3.1.1. Aktivitetet planifikohen në përputhje me komponentët e Programit "Pas Shkolle" dhe modelin organizativ të tij.
- 3.1.2. Planifikimi i aktiviteteve merr në konsideratë moshën, nivelin e arsimit, interesat dhe nevojat e nxënësve.
- 3.1.3. Programi ofron një gamë të larmishme aktiviteteve që mbështesin zhvillimin personal, social, kulturor, artistik dhe qytetar të nxënësve.
- 3.1.4. Planifikimi i aktiviteteve mbështetet në burimet dhe mundësitë e institucionit arsimor dhe të komunitetit. Aktivitetet e Programit nuk përsërisin mekanikisht procesin e rregullt mësimor, por mbështeten në të nxënit përmes përvojës, lojës, projekteve, krijimtarisë, bashkëpunimit dhe zbatimit praktik të njohurive.

Standardi 3.2: Zhvillimi i aktiviteteve të Programit "Pas shkolle"

Përshkrimi i standardit: Aktivitetet e Programit "Pas Shkolle" zhvillohen në një mjedis edukativ që nxit pjesëmarrjen aktive, bashkëpunimin, krijimtarinë dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

Treguesit:

- 3.2.1. Aktivitetet zhvillohen duke nxitur angazhimin aktiv dhe bashkëpunimin ndërmjet nxënësve.
- 3.2.2. Programi krijon mundësi për të nxënë përmes përvojës, eksplorimit, krijimtarisë dhe punës në grup.
- 3.2.3. Aktivitetet mbështesin zhvillimin e kompetencave, aftësive për jetën, interesave dhe talenteve të nxënësve.
- 3.2.4. Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve promovojnë një mjedis edukativ motivues, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt zhvillimit të gjithanshëm të nxënësve.

FUSHA IV: STAFI DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Kjo fushë përcakton standardet që lidhen me kompetencat profesionale të stafit të angazhuar dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional, si elemente thelbësore për garantimin e cilësisë së Programit "Pas Shkolle". Stafi i Programit "Pas Shkolle" përfshin drejtuesit e institucionit arsimor, psikologun/punonjës social, oficerin e sigurisë dhe stafin tjetër mbështetës, si dhe trajnuesit, të cilët zhvillojnë drejtpërdrejt me nxënësit aktivitetet e programit, sipas kategorive dhe kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

Standardi 4.1: Kompetencat profesionale të stafit

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" mbështetet nga stafi (drejtues, psikologun/punonjës social, trajnues dhe staf tjetër mbështetës) që zotëron kompetencat profesionale, pedagogjike dhe etike të nevojshme për rolin përkatës në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve edukative.

Treguesit:

- 4.1.1. Trajnuesit zotërojnë kompetencat profesionale, pedagogjike dhe të fushës, të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të Programit "Pas Shkolle", në përputhje me kategoritë dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.
- 4.1.2. Drejtuesit e institucionit arsimor, psikologun/punonjës social dhe stafi tjetër mbështetës zotërojnë kompetencat e nevojshme për mbështetjen e organizimit dhe funksionimit të programit.
- 4.1.3. Marrëdhëniet me nxënësit mbështeten në respekt, besim dhe përgjegjësi profesionale.
- 4.1.4. Stafi bashkëpunon për krijimin e një mjedisi edukativ të sigurt, gjithëpërfshirës dhe motivues.
- 4.1.5. Veprimtaria profesionale zhvillohet në përputhje me etikën profesionale dhe legjislacionin në fuqi. Personat që angazhohen drejtpërdrejt me nxënësit plotësojnë kriteret profesionale, etike dhe ligjore të përcaktuara në aktet në fuqi.

Standardi 4.2: Zhvillimi profesional i stafit

Përshkrimi i standardit: Institucioni arsimor mbështet zhvillimin profesional të vazhdueshëm të stafit të angazhuar në Programin "Pas Shkolle", me synim përmirësimin e cilësisë së organizimit dhe zhvillimit të programit.

Treguesit:

- 4.2.1. Stafi merr pjesë në veprimtari të zhvillimit profesional që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle".
- 4.2.2. Zhvillimi profesional mbështet përmirësimin e praktikave pedagogjike dhe organizative të programit.
- 4.2.3. Stafi shkëmben përvoja dhe praktika profesionale me kolegët për përmirësimin e cilësisë së Programit "Pas Shkolle".
- 4.2.4. Institucioni arsimor krijon mundësi për zhvillimin profesional dhe mbështetjen e vazhdueshme të stafit të angazhuar në program.

FUSHA V: BASHKËPUNIMI ME FAMILJEN DHE KOMUNITETIN

Kjo fushë përcakton standardet që lidhen me bashkëpunimin e institucionit arsimor me familjen dhe komunitetin për planifikimin, zhvillimin dhe pasurimin e Programit "Pas Shkolle". Bashkëpunimi ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit mbështet mirëqenien e nxënësve, zgjeron mundësitë e të nxënësve dhe kontribuon në zhvillimin e një programi të lidhur me jetën dhe nevojat e komunitetit.

Standardi 5.1: Bashkëpunimi me familjen

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" zhvillohet në partneritet me familjen, duke promovuar komunikimin, bashkëpunimin dhe përfshirjen e prindërve në mbështetje të zhvillimit dhe mirëqenies së nxënësve.

Treguesit:

- 5.1.1. Institucioni arsimor siguron komunikim të rregullt me prindërit për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle".
- 5.1.2. Prindërit informohen për qëllimin, aktivitetet dhe organizimin e programit.
- 5.1.3. Prindërit inkurajohen të kontribuojnë në mbështetje të Programit "Pas Shkolle", në përputhje me mundësitë dhe format e bashkëpunimit të përcaktuara nga institucioni arsimor.
- 5.1.4. Bashkëpunimi me familjen mbështet pjesëmarrjen, mirëqenien dhe zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve.

Standardi 5.2: Bashkëpunimi me komunitetin

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" zhvillon partneritete me institucione, organizata dhe aktorë të komunitetit për të pasuruar përvojat edukative dhe për të zgjeruar mundësitë e të nxënësve.

Treguesit:

- 5.2.1. Institucioni arsimor krijon dhe zhvillon partneritete me institucione, organizata dhe aktorë të komunitetit në funksion të Programit "Pas Shkolle".
- 5.2.2. Burimet, ekspertiza dhe mjediset e komunitetit përdoren për pasurimin e aktiviteteve të programit, kur është e mundur.
- 5.2.3. Bashkëpunimi me komunitetin mbështet zhvillimin e aktiviteteve që lidhen me jetën reale, qytetarinë aktive dhe orientimin e nxënësve.
- 5.2.4. Partneritetet me komunitetin kontribuojnë në zhvillimin cilësor dhe të qëndrueshëm të Programit "Pas Shkolle".

FUSHA VI: ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE BURIMET E PROGRAMIT

Kjo fushë përcakton standardet që lidhen me organizimin, drejtimin dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për zhvillimin cilësor të Programit "Pas Shkolle". Organizimi dhe drejtimi i programit mbështeten në planifikim, koordinim dhe përdorim efektiv të burimeve, duke garantuar zhvillimin e rregullt të aktiviteteve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për pjesëmarrjen e nxënësve.

Standardi 6.1: Organizimi dhe drejtimi i Programit

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" organizohet dhe drejtohet në mënyrë të planifikuar dhe të koordinuar, në përputhje me modelin organizativ të programit, nevojat e nxënësve dhe burimet në dispozicion.

Treguesit:

- 6.1.1. Institucioni arsimor planifikon organizimin e Programit "Pas Shkolle" në përputhje me aktet rregullatore dhe standardet e programit.
- 6.1.2. Organizimi i programit mbështetet në një ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësi të stafit të angazhuar.
- 6.1.3. Programi zhvillohet sipas një planifikimi që siguron vazhdimësinë dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve gjatë vitit shkollor.
- 6.1.4. Organizimi i programit mbështet koordinimin ndërmjet drejtimit të institucionit arsimor, stafit të angazhuar, familjes dhe partnerëve të komunitetit.

Standardi 6.2: Burimet dhe mjediset e Programit

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" zhvillohet në mjedise të përshtatshme dhe mbështetet në burime njerëzore, materiale dhe organizative që garantojnë zhvillimin cilësor të aktiviteteve edukative.

Treguesit:

- 6.2.1. Mjediset e përdorura janë të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të Programit "Pas Shkolle".
- 6.2.2. Pajisjet, materialet dhe burimet e tjera mbështesin realizimin e aktiviteteve edukative.
- 6.2.3. Organizimi i mjediseve dhe përdorimi i burimeve garantojnë sigurinë dhe aksesueshmërinë për nxënësit.
- 6.2.4. Burimet e institucionit arsimor dhe të komunitetit përdoren në mënyrë efektive për pasurimin e programit.

FUSHA VII: MONITORIMI, VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI I PROGRAMIT

Kjo fushë përcakton standardet që lidhen me monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Programit "Pas Shkolle". Ajo synon të garantojë që zhvillimi i programit të mbështetet në analizën e rezultateve, reflektimin mbi praktikën dhe përdorimin e informacionit për përmirësimin e cilësisë së tij.

Standardi 7.1: Monitorimi dhe vlerësimi i Programit

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë sistematike për të siguruar zbatimin e standardeve dhe për të identifikuar mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të programit.

Treguesit:

- 7.1.1. Institucioni arsimor monitoron zbatimin e Programit "Pas Shkolle" në përputhje me standardet dhe aktet rregullatore në fuqi.
- 7.1.2. Monitorimi mbështetet në mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi organizimin, zhvillimin dhe rezultatet e programit.
- 7.1.3. Në procesin e vlerësimit merren në konsideratë mendimet e nxënësve, prindërve, stafit të angazhuar dhe partnerëve të tjerë, sipas rastit.
- 7.1.4. Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit dokumentohen dhe përdoren për përmirësimin e Programit "Pas Shkolle".

Standardi 7.2: Përmirësimi i vazhdueshëm i Programit

Përshkrimi i standardit: Programi "Pas Shkolle" përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, duke u mbështetur në rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit, në bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të përfshirë dhe në nevojat e nxënësve.

Treguesit:

- 7.2.1. Institucioni arsimor identifikon pikat e forta dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim në organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle".
- 7.2.2. Në bazë të rezultateve të monitorimit dhe vetëvlerësimit planifikohen masa konkrete për përmirësimin e programit.
- 7.2.3. Përmirësimi i Programit "Pas Shkolle" mbështetet në reflektimin institucional, bashkëpunimin ndërmjet stafit dhe shkëmbimin e praktikave të mira.
- 7.2.4. Institucioni arsimor ndjek zbatimin e masave të planifikuara dhe vlerëson efektivitetin e tyre në përmirësimin e cilësisë së Programit "Pas Shkolle", në bashkëpunimin ndërmjet institucionit arsimor, familjes dhe komunitetit.

KAPITULLI IV: ZBATIMI I STANDARDEVE

Zbatimi i standardeve

Standardet për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle" shërbejnë si kuadër orientues për planifikimin, organizimin, zhvillimin, monitorimin dhe përmirësimin e programit në institucionet e arsimit parauniversitar. Institucionet arsimore organizojnë Programin "Pas Shkolle" në përputhje me këto standarde, duke marrë në konsideratë nevojat e nxënësve, karakteristikat e institucionit arsimor dhe burimet në dispozicion.

Përdorimi i standardeve

Standardet përdoren nga institucionet arsimore për:

- a) planifikimin dhe organizimin e Programit "Pas Shkolle";
- b) zhvillimin dhe përmirësimin e aktiviteteve edukative;
- c) vetëvlerësimin dhe monitorimin e programit;
- ç) identifikimin e nevojave për zhvillim profesional të personelit;
- d) forcimin e bashkëpunimit me familjen dhe komunitetin;
- dh) mbështetjen e zhvillimit të vazhdueshëm të Programit "Pas Shkolle".

Përgjegjësitë për zbatimin e standardeve

Institucioni arsimor është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle" në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë dokument.

Drejtuesit e institucionit arsimor, personeli i angazhuar në program dhe aktorët e tjerë të përfshirë bashkëpunojnë për zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të Programit "Pas Shkolle", në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

Zbatimi i standardeve mbështetet edhe nga strukturat e tjera të sistemit arsimor parauniversitar, sipas përgjegjësive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi: ASCAP mbështet zhvillimin e standardeve dhe instrumenteve të cilësisë, zhvillimin profesional të personelit të angazhuar dhe analizën e rezultateve të zbatimit të Programit, sipas përgjegjësive të përcaktuara në aktet në fuqi. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) mbështet organizimin e Programit "Pas Shkolle" në nivel kombëtar; Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) mbështesin, monitorojnë dhe raportojnë periodikisht mbi zbatimin e standardeve nga institucionet arsimore në juridiksionin e tyre; Ministria e Arsimit ndjek në

vazhdimësi zbatimin e standardeve dhe orienton përmirësimin e politikave që lidhen me Programin "Pas Shkolle".

Rishikimi i standardeve

Standardet për organizimin dhe zhvillimin e Programit "Pas Shkolle" rishikohen pas një periudhe fillestare zbatimi dhe më pas sipas nevojës, bazuar në rezultatet e monitorimit, ndryshimet ligjore dhe zhvillimet e politikave arsimore.

KAPITULLI V: INSTRUMENT ORIENTUES PËR VETËVLERËSIMIN E PROGRAMIT "PAS SHKOLLE"

Ky instrument mbështet institucionet arsimore në vetëvlerësimin e organizimit dhe zhvillimit të Programit "Pas Shkolle", në përputhje me standardet e Programit. Vetëvlerësimi synon të nxisë reflektimin e institucionit arsimor mbi praktikën e tij, të evidentojë pikat e forta dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim, si dhe të mbështesë planifikimin e masave për zhvillimin e mëtejshëm të Programit. Instrumenti nuk ka karakter inspektues apo vlerësues nga jashtë, por përdoret nga vetë institucioni arsimor si pjesë e procesit të përmirësimit të vazhdueshëm. Vlerësimi mbështetet në analiza të përbashkëta të ekipit që zbaton Programin dhe në burime të ndryshme verifikimi, si dokumentacioni i Programit, planet e aktiviteteve, raportet e monitorimit, pyetësorët, fotografitë dhe burime të tjera që dëshmojnë nivelin e përmbushjes së standardeve. Për secilin standard, institucioni arsimor vlerëson nivelin e përmbushjes, evidenton burimet përkatëse të verifikimit dhe përcakton masat që do të ndërmerren për përmirësimin e mëtejshëm të Programit. ***Shpjegimi i niveleve të përmbushjes:*** Për të siguruar një interpretim të njëjtë të niveleve të vlerësimit, përdoren përshkrimet e mëposhtme:

<i>Niveli</i>	<i>Përshkrimi</i>
Nuk përmbushet	Standardi nuk zbatohet ose zbatohet në një masë shumë të kufizuar dhe nuk siguron arritjen e kërkesave të tij.
Përmbushet pjesërisht	Standardi zbatohet pjesërisht. Evidentohen praktika pozitive, por ato nuk janë të qëndrueshme ose nuk mbulojnë të gjitha aspektet e standardit.
Përmbushet kryesisht	Standardi zbatohet në shumicën e elementeve të tij. Praktikën janë përgjithësisht të qëndrueshme, megjithëse evidentohen disa aspekte që kërkojnë përmirësim.
